

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5661
E hënë, 24 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

DIALOGU



Kadri VESELI

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

KOHA E RAMUSH HARADINAJT F. 17

Bedri ISLAMI



VAZHDON PËRPLASJA VETËVENDOSJE - PSD F. 7

NË 29-VJETORIN E LDK-SË, MUSTAFA IA NUMËRON DËSHTIMET KOALICIONIT QEVERISËS F. 7



NDAHET NGA JETA PADDY ASHDOWN F. 7

EKONOMI

A DO TË KETË NDËSHKIME TË REJA FINANCIARE PËR AUTOSTRADËN PRISHTINË - SHKUP? F. 9

LËSHOHET NË QARKULLIM PULLA POSTARE 'DËSHMORËT E GJAKOVËS' F. 9

SPORT



KONFIRMOHET MIQËSORJA NDAJ DANIMARKËS F. 18

VETTELI: NË 2019-N SYNOJ TITULLIN E KAMPIONIT F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", XHAFER TAHIRI | FAQE 4-5

Ekipi negociator s'mund t'i sjellë Kosovës marrëveshje të dobishme

Anëtari i Këshillit të Përgjithshëm të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), njëherësh kryetar i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka vlerësuar se ekipi negociator për dialogun me Serbinë nuk ka legjitimitet dhe mbështetje qytetare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky ekip nuk ka kapacitet për t'i sjellë Kosovës marrëveshje të dobishme. Tahiri ka theksuar se partitë aktuale nuk kanë mandat dhe legjitimitet demokratik për ta përfunduar me sukses procesin e dialogut. Ai ka thënë se për t'u arritur një zë unik karshi dialogut siç po kërkon ShBA-ja, partitë politike duhet të kthehen te sovranit për ta marrë mbështetjen e qytetarëve. Tahiri ka theksuar se pa LDK-në nuk mund të merren vendime të mëdha për Kosovën



Kurti tregon arsyen pse Kosova duhet të arrijë marrëveshje me Serbinë deri në pranverë

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të dielën se paralajmërimi i arritjes së marrëveshjes me Serbinë deri në pranverë të vitit të ardhshëm nga liderët institucionalë po bëhet për shkak të Gjykatës Speciale. Sipas tij, presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj afatin e skadimit të shtuar për së dyti mbi ambalazh e kanë që të dy të njëjtë



Lekaj u bë në thirrje mërgimtarëve: Kujdes gjatë lëvizjes në komunikacion

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANKAR VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ndahet nga jeta Paddy Ashdown

Paddy Ashdown, një ish-marins dhe politikan opozitar britanik i cili shërbeu si i dërguari i posaçëm ndërkombëtar në Bosnjë pas luftës në ish-Jugosllavi, vdiq të shtunën në moshën 77-vjeçare. Udhëheqësit e Kosovës e kujtuan të dielën atë si një nga mbështetësit e fuqishëm të ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë dhe njeriun që kishte dëshmuar kundër ish-presidentit serb Slobodan Millosheviq



LONDËR, 23 DHJETOR - Paddy Ashdown, një ish-marins dhe politikan opozitar britanik i cili shërbeu si i dërguari i posaçëm ndërkombëtar në Bosnjë pas luftës në ish-Jugosllavi, vdiq të shtunën. Ai ishte 77 vjeç.

Ashdown u largua nga posti i tij në Bosnjë në vitin 2006 pas gati katër vjetësh në atë post, por kishte qenë në krye të përpjekjeve të paqes në Ballkan shumë kohë para se të fillonte këtë detyrë.

Ashdown shpejt krijoi një reputacion si një zbatues praktik i masave të ashpra për të ndihmuar vendin të shërohet nga lufta e tij në vitet 1992-1995. Gjatë mandatit të tij, Ashdown shkarkoi zyrtarë të korruptuar dhe Bosnja, përfundoi disa reforma të dhimbshme që synonin forcimin e institucioneve qendrore në kurriz të dy entiteteve të pasluftës - Republika Srpska e serbëve dhe Federata Myslimano-Kroate.

Ato përfshijnë kryesisht reforma të mbrojtjes që synonin bashkimin e dy ushtrive etnike të ndara në një, si dhe forcat policore, doganat dhe reformat tatimore.

Për shërbimin e tij ndaj vendit dhe në botë, Jeremy John Durham Ashdown, u nderua

nën emrin e tij të vërtetë Jeremy në vitin 2000 dhe u bë anëtar i Dhomës së Lartë të parlamentit. I martuar, me dy fëmijë, Ashdown jetonte në Yeovil, në jugperëndim të Anglisë.

Kosova kujton lordin Ashdown

Udhëheqësit e Kosovës e kujtuan të dielën Ashdown si një nga mbështetësit e fuqishëm të ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë dhe njeriun që kishte dëshmuar kundër ish-presidentit serb Slobodan Millosheviq, derisa mbahej procesi gjyqësor kundër tij për krime lufte dhe gjenocid në hapësirat e ish-Jugosllavisë. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, duke ngushëlluar familjen Ashdown u shpreh i "pikëlluar për vdekjen e mikut të Kosovës, diplomatit britanik, Paddy Ashdown. Ai ishte zëri më i fuqishëm i intervenimit të NATO-s për të parandaluar spastrimin etnik në Kosovë. Ashdown ishte, po ashtu, një mbështetës i flaktë i pavarësisë së Kosovës".

Kryeministri Ramush Haradinaj, po ashtu e quajti pikëllues lajmin për vdekjen e mikut të Kosovës, Paddy

Ashdown, i cili për një dekadë udhëhoqi partinë Liberale Demokratike në Britani dhe kishte shërbyer si emisar i Qeverisë britanike gjatë luftës në Kosovë. Ashdown ishte një nga përkrahësit më të mëdhenj të intervenimit ushtarak të NATO-s në Kosovë dhe dëshmitar në Tribunalin e Hagës, kundër Millosheviqit. Ngushëllime të thella për familjen dhe miqtë e liberalit të madh, Ashdown!"

Lordi Ashdown, ishte kundër ideve që gjatë verës u hodhën nga presidenti i Kosovës Hashim Thaçi dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq për një marrëveshje që do të mund të prekte edhe kufijtë e Kosovës. Më 29 gusht ai dhe dy ish-për-

faqësuesit e lartë në Bosnjë, Carl Bildt, Christian Shwarz Schilling, shfaqën shqetësimin e thellë mbi paralajmërimet se zyrtarë të Bashkimit Evropian mund të jenë të gatshëm të mbështesin një marrëveshje ndërmjet presidentëve Thaçi e Vuçiq që përfshinë shkëmbimin e territoreve nëpërmjet "korigjimit të kufirit".

Në një letër drejtuar shefes së politikës së Jashtme të BE-së, Federica Mogherini ata shfaqën drojën se lëvizja e kufijve "nuk do t'i zgjidhë ndarjet, por do t'i thellojë ato" dhe i bënë thirrje asaj t'i hedhë poshtë idetë e tilla. "Ne e njohim Bashkimin Evropian dhe Evropën mjaftueshëm për të ditur se historia e përgjakshme na ka

mësuar që paqja e qëndrueshme mund të vendoset vetëm kur mësohemi të jetojmë në vende shumetnike në vend se të ri-vizatojmë kufijtë për të krijuar shtete njëetnike. Shkurt, nuk mund të mendohet ndonjë politikë tjetër që ka më shumë gjasa të na çojë në ndarje dhe konflikt në Ballkan sesa ajo që disa tani duket se po mbështesin", thuhej mes tjerash në letër në të cilën shfaqeshin dyshimet se kjo rrezikon marrëveshjet si në Maqedoni, dëmton unitetin e shteteve si Bosnja, duke inkurajuar ata që dëshirojnë të shohin shkëmbimin e territoreve diku tjetër, siç është Ukraina dhe ka gjasa të çojë në eksodin e pakicave nga komunitetet e tyre ekzistuese.

Ligji për gjuhët në Maqedoni, pas ndryshimeve kushtetuese



SHKUP, 23 DHJETOR - Pushteti në Maqedoni nuk do të presë as firmën e presidentit, Gorge Ivanov dhe as presidentin e ardhshëm për ta shpallur në Gazetën Zyrtare Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Këtë ligj dhe marrëveshjen e Prespës kryeparlamentari Talat Xhaferi do t'i dorëzojë në Gazetë

Zyrtare menjëherë pas miratimit të ndryshimeve kushtetuese gjatë muajit janar.

"Nuk presim dhe nuk shpresojmë që të kemi ndonjë marrëveshje me presidentin lidhur me Ligjin e gjuhëve. Unë mendoj që pas përfundimit të procesit të ndryshimeve kushtetuese do të

vijojë edhe publikimi i marrëveshjes me Greqinë, si parakusht për të vazhduar procesin në Greqi edhe Ligji i gjuhëve. Dhe të dy këto ligje do të publikohen nga kryetari i Kuvendit në Gazetën Zyrtare, në kuadër të Kushtetutës si rezultat i mosrespektimit të Kushtetutës

nga presidenti", tha Bujar Osmani, zëvendëskryeministër për Çështje Evropiane. Osmani shtoi se Shkupi ka besim të plotë se Qeveria aktuale greke ka shumicën e nevojshme për ta ratifikuar Marrëveshjen e Prespës dhe protokollin për anëtarësimin e vendit në NATO.

Vazhdojnë demonstratat antiqeveritare në Beograd

BEOGRAD, 23 DHJETOR - Mijëra veta morën pjesë në një protestë në Beograd kundër politikave të presidentit Aleksandër Vuçiq dhe kërkuan që t'i jepet fund dhunës politike si dhe raportim më të drejtë nga televizioni publik. Protesta e së shtunës ishte e treta me radhë që kur ndodhi një sulm

mbi Borislav Stefanoviçin, udhëheqës i partisë së vogël "E Majta serbe". Stefanoviç ishte sulmuar nga një grup burrash me maska të zeza më 23 nëntor në Krushevc, dhe kishte pësuar plagë të lehta. Protesta me sloganin "Një nga pesë milionë", sipas organiza-

torëve mbledhi 35 mijë deri në 40 mijë veta, ndërsa ministri i Brendshëm serb, Nebojsa Stefanoviç, tha se ishin më së shumti pesë mijë. Veprimtarët e opozitës thonë se presidenti Vuçiq është një autokrat dhe e cilësojnë partinë e tij të korruptuar. Ata thonë se

presidenti Vuçiq kontrollon pjesën më të madhe të medieve në Serbi, gjë që i siguron atij përparësi të padrejtë. Mbështetja për presidentin Vuçiq ka shënuar një rënie të vogël pas fitores së tij të thellë në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016, por ai mbetet udhëheqësi politik më



popullor dhe koalicioni i tij në pushtet ka një shumicë të qëndrueshme prej 160 deputetësh në parlamentin me 250 vende.

Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka mbajtur të dielën mbledhjen e 35-të të Këshillit të Përgjithshëm

Kurti tregon arsyen pse Kosova duhet të arrijë marrëveshje me Serbinë deri në pranverë



Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të dielën se paralajmërimi i arritjes së marrëveshjes me Serbinë deri në pranverë të vitit të ardhshëm nga liderët institucionalë po bëhet për shkak të Gjykatës Speciale. Sipas tij, presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj afatin e skadimit të shtuar për së dyti mbi ambalazh e kanë që të dy të njëjtë

blerjeve dhe shantazhimeve. Paralajmërojnë se duhet të arrihet marrëveshja deri në pranverë. A e dini pse? Sepse aq zgjat imuniteti i Thaçit nga Gjykata Speciale, pra për aq kohë sa ndodhet znj. Mogherini në detyrën e saj. Kurse Haradinaj nuk mund të zgjasë pas Thaçit. Afatin e skadimit, të shtuar për së dyti mbi ambalazh, e kanë që të dy të njëjtë. Thaçi thotë një fjali: kompromis të dhimbshëm me korrigjim të kufijve. Haradinaj shkroi 30 faqe: kompromis të dhimbshëm pa korrigjim të kufijve. Ne themi e shkruajmë e bëjmë: mjaft dhimbje ka pasur Kosova me këta", ka thënë Kurti. Në këtë mbledhje ai ka folur edhe për çështje të tjera. Sipas

Kurtit, në vitin 2018 nuk ka pasur vetëm tradhti në Kosovë e dialog për Serbinë. "Ka pasur edhe vdekje të punëtorëve në vendet e punës, të cilave qeveria u është përgjigjur me indiferencë. Sepse kjo është një qeveri mike e korporatave dhe kompanive që abuzojnë me punëtorët, dhe jo mike e punëtorëve. Prandaj qindra punëtorë janë drejtuar të Lëvizja Vetëvendosje! dhe janë anëtarësuar te ne, ndër ta edhe Përparim Sadiku, punëtori i 'Bechtel Enkas' që mbeti i varur në lartësi të madhe për dy orë, e që shpëtoi për mrekulli. Kushtet e këqija për punëtorët mirëmbahen nga papunësia e madhe. Është vështirë të luftosh për të drejta kur ke shumë të papunë

që janë të gatshëm ta marrin vendin tënd të punës ndërkohë që ti proteston", është shprehur Kurti.

I pari i Lëvizjes Vetëvendosje ka vlerësuar se qeveria nuk ka bërë asgjë për zbutjen e papunësisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës. "Përkundrazi, qeveria sivjet ka marrë vendimin absurd të rritjes së rrogës për kryeministrin, ministrat, batalionin me zëvendësministra dhe armatën me këshilltarë. Tash e kemi kryeministrin me rrogën më të lartë në Ballkan, ndërkohë që jemi vendi me të ardhura më të ulëta për frymë në krejt Evropën dhe vendi me rrogë mesatare ndër më të ulëtat jo vetëm në Evropë", ka deklaruar Kurti.

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka treguar të dielën pse presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj po e paralajmërojnë marrëveshjen me Serbinë deri në pranverë të

vitit 2019. Në mbledhjen e 35-të të Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje, Kurti ka deklaruar se kjo po bëhet për shkak të Gjykatës Speciale. "Është fatkeqësi për Kosovën që dialogu i cili do ta përcaktojë fatin tonë të përgjithshëm, përcaktohet nga një njeri i cili mbështetjen e siguron përmes

Lekaj u bënë thirrje mërgimtarëve: Kujdes gjatë lëvizjes në komunikacion

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka bërë thirrje për kujdes gjatë lëvizjes në komunikacion. Përmes një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook", Lekaj u drejtohet mërgimtarëve që vizitojnë Kosovën për festat e fundvitit. Ai ka thënë se ministria që drejton do të vazhdojë të përkujdeset për mirëmbajtjen e rrugëve në këtë kohë dimri. "Bashkëqytetarë që jetoni e veproni në diasporë. Kosova, e veçanërisht familjet

e juaja, janë në pritje dhe të gëzuar që ju i vizitoni për festat e fundvitit. Rrugët në Kosovë, shumë nga ato janë të ndërtuara, të sinjalizuara dhe të kalueshme. Mirëpo prapë kjo nuk nënkupton që duhet ta rrezikoni veten dhe të tjerët në komunikacion, duke vozitur shpejt, sidomos tani kur jemi në stinën e ftohtë të dimrit, sepse shpejtësia dhe mospërshtatja me kushtet në rrugë po dalin të jenë faktorët kryesorë të aksidenteve, disa prej të cilave me

fatalitet, siç ndodhi në aksidentin e fundit, ku humbi jetën një qytetar, duke e lënë familjen në pikëllim të përjetshëm. Ne si Ministri do të vazhdojmë të bëjmë çdo gjë që është në dorën tonë, që të kemi rrugë të ndërtuara, të sinjalizuara dhe të mirëmbajtura mirë. Duke ju thënë ejani në vendlindje, të gëzohemi bashkë, në të njëjtën kohë ju bëjmë apel t'i respektoni rregullat e komunikacionit sepse familja ju pret!", ka shkruar Lekaj.



Flet për "Epokën e re", Xhafer Tahiri

Ekipi negociator s'mund t'i sjellë Kosovës marrëveshje të dobishme

Anëtari i Këshillit të Përgjithshëm të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), njëherësh kryetar i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka vlerësuar se ekipi negociator për dialogun me Serbinë nuk ka legjitimitet dhe mbështetje qytetare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky ekip nuk ka kapacitet për t'i sjellë Kosovës marrëveshje të dobishme. Tahiri ka theksuar se partitë aktuale nuk kanë mandat dhe legjitimitet demokratik për ta përfunduar me sukses procesin e dialogut. Ai ka thënë se për t'u arritur një zë unik karshi dialogut siç po kërkon ShBA-ja, partitë politike duhet të kthehen te sovrani për ta marrë mbështetjen e qytetarëve. Tahiri ka theksuar se pa LDK-në nuk mund të merren vendime të mëdha për Kosovën

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 23 DHJETOR - "Epoka e re": Z. Tahiri, me çfarë bilanci po e përmyll këtë vit Komuna e Vushtrrisë?

Tahiri: Vlerësoj se ka qenë një vit i mirë për qytetin e Vushtrrisë, me lajme të rëndësishme sa i përket zhvillimit ekonomik, por edhe me një investim të shtuar në arsim, shëndetësi dhe infrastrukturë. Ajo që ka karakterizuar qytetin e Vushtrrisë është bashkimi i qytetarëve dhe i partive politike në kuvendin komunal për një ndryshim cilësor. Kemi ofruar një shembull të qeverisjes ndryshe, një qeverisje transparente dhe llogaridhënëse ashtu siç kemi premtuar. Jemi vlerësuar komuna me prokurimin më të mirë nga USAID-i dhe kjo është e arritur shumë e madhe për administratën e Vushtrrisë. Kemi ndërtuar një administratë profesionale dhe tanimë shërbimet ofrohen në nivelin më të lartë. Kemi bërë reforma substanciale në shëndetësi dhe qytetarët janë duke e vërejtur ndryshimin që po ndodh. Edhe në arsim kemi bërë forma të rëndësishme duke ndërtuar katërmbëdhjetë kënde për lexim për herë të parë nëpër shkollat e Vushtrrisë. Gjithashtu, kemi investuar në renovimin dhe ndërtimin e shkollave të reja. Vitin e ardhshëm do ta kemi çerdhen e re dhe shkollën e muzikës.

"Epoka e re": Cilat do të jenë prioritetet e komunës në vitin e ardhshëm?

Tahiri: Do të fokusohemi në

projektimin e stacionit të autobusëve, tregut për prodhuesit vendorë dhe zonës ekonomike. Janë tri projekte të mëdha kapitale krahas projekteve në infrastrukturë që do të realizohen brenda qytetit të Vushtrrisë me qëllim që të kemi përmirësim të jetës së qytetarëve. Vitin e ardhshëm do ta fillojmë zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kyçjen e fshatrave në ujësjellës. Ky projekt do të realizohet qoftë me fonde nga qeveria, qoftë me fonde vetjake të komunës.

"Epoka e re": Të dielën LDK-ja ka shënuar 29-vjetorin e saj. Si e komentoni këtë rrugëtim?

Tahiri: LDK-ja është një nga partitë modele jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon për forcën shtetformuese dhe për forcën transformuese për shoqërinë e Kosovës. LDK-ja ka artikuluar më së miri kërkesën e shqiptarëve të Kosovës dhe të kombit shqiptar për liri, pavarësi dhe demokraci. Kjo është forca shtetformuese dhe transformuese që ka karakterizuar LDK-në në këto vite. Janë 29 vjet të përpjekjes për një jetë më të mirë të qytetarëve. Kjo veprimtari pozitive e LDK-së i ka dhënë imazh Kosovës si dhe e ka orientuar popullin drejt vlerave perëndimore në çastet kyçe të historisë së vendit.

"Epoka e re": Sa jeni të kënaqur me rolin opozitar të LDK-së gjatë këtij mandati?

Tahiri: LDK-ja është partia më e madhe në Kuvend. Është partia më e madhe që udhëheq komunat. Megjithatë, LDK-ja është në opozitë, por ka luajtur rol konstruktiv dhe korrektues ndaj

veprimeve të qeverisë. Nuk mund të merren vendime të mëdha për Kosovën pa LDK-në. Procesi i dialogut ka sjellë më shumë dëm sesa dobi për faktin se partitë që vazhdojnë të jenë në dialog nuk e kanë mbështetjen qytetare. Ata mund të kenë numra në Kuvend, por jo edhe legjitimitetin qytetar, prandaj nuk mund ta përfaqësojnë shumicën e shqiptarëve në këtë proces. Për të pasur sukses dialogu dhe për t'u arritur marrëveshja përfundimtare partitë politike duhet të kthehen te sovrani për të kërkuar mandat nga populli, tek pastaj duhet ta vazhdojmë rrugëtimin drejt arritjes së marrëveshjes përfundimtare me Serbinë.

"Epoka e re": LDK-ja në vazhdimësi deri më tani ka pasur një qasje konstruktive kur kanë qenë në pyetje interesat e shtetit dhe proceset e mëdha, por një gjë e tillë nuk po ndodh edhe tani me procesin e dialogut. Pse LDK-ja vendosi të rrijë anash dialogut?

Tahiri: LDK-ja e ka përkrahur dhe e përkrah dialogun i cili zhvillohet nga institucionet legjitime, nga institucionet që kanë mandat nga populli për ta zhvilluar këtë proces. Institucionet aktualisht dhe partitë aktuale nuk e kanë mandatin dhe legjitimitetin demokratik për ta përfunduar me sukses procesin e dialogut. Prandaj LDK-ja kërkon që të kthehemi te sovrani në zgjedhje dhe të rimandatohet një shumicë e re parlamentare e cila do ta përfundojë dialogun me Serbinë. LDK-ja në vazhdimësi ka qenë vendimtare në secilin

proces dhe do të vazhdojë të jetë e tillë në proceset e rëndësishme për Republikën e Kosovës.

"Epoka e re": Ka kohë të mjaftueshme për të shkuar në zgjedhje dhe për ta marrë legjitimitetin duke pasur parasysh thirrjet e aleatëve, në veçanti të ShBA-së, që Kosova të krijojë një zë unik karshi dialogut?

Tahiri: Vetëm Serbia ka presion të përmyllet sa më shpejt procesi dhe të arrihet marrëveshja. Kosova nuk ka asnjë presion. Neve nuk po na pret asnjë proces i rëndësishëm për ta përmyllur dialogun siç po e pret, për shembull, Serbinë mbyllja e kapitullit të 25 të MSA-së. ShBA-ja e ka përkrahur dhe jemi mirënjohës për përkrahjen e vazhdueshme të saj. Është pikërisht LDK-ja dhe presidenti Rugova që ka ndërtuar këtë miqësi të përhershme me Amerikën dhe duhet ta ruajmë këtë si miqësi të më të rëndësishme dhe si aleancat absolutisht më jetike. Por ShBA-ja nuk ka thënë se duhet të arrihet marrëveshja në çdo formë, mirëpo ka kërkuar që marrëveshja të arrihet dhe të jetë e qëndrueshme.

"Epoka e re": Si e keni parë letrën e presidentit amerikan dërguar presidentit të Kosovës?

Tahiri: Qëndrimi amerikan është konsistent dhe ky qëndrim është shprehur qysh nga koha e presidentit tashmë të ndjerë, George Bush. Duhet ta avancojmë partneritetin strategjik me ShBA-në sepse është partneriteti i sinqertë në

mes të dy popujve. Letra e presidentit amerikan pa diskutim se është një mbështetje për Kosovën dhe për procesin final të Kosovës e jo për individët. Por, që Kosova të ketë sukses, duhet të ketë njerëz legjitimë në krye të procesit. Një parti politike e cila i ka 2-3 për qind mbështetje dhe që është krijuar në Kuvend nuk mund ta përfaqësojë opozitën në dialog.

"Epoka e re": Pas kërkesave të





ndërkombëtarëve është krijuar njëfarë përshtypje se gjatë rrugëtimit LDK-ja do të bëhet pjesë e këtij procesi. Mund të ndodhë një gjë e tillë apo përfundimisht LDK-ja do të jetë anash dialogut?

Tahiri: Ata që mendojnë kështu duan që të vendosin presion mbi LDK-në duke aluduar se kjo parti ndërron qëndrime. LDK-ja është shprehur qartë dhe është e vetmja që ka një platformë për dialogun. LDK-ja është krenare

që së bashku me presidentin Rugova 29 vjet më parë e ka orientuar popullin e Kosovës drejt vlerave euroatlantike. Miqësia e LDK-së me Amerikën është duke vazhduar për gati tri dekada dhe kjo miqësi nuk do të prishet për asnjë çmim dhe rrethanë. Në këta 29 vjet qëndrimet e LDK-së gjithmonë kanë qenë për interesat e Kosovës dhe popullit të saj. Nuk do të ndodhë asnjëherë që LDK-ja të jetë në shpërputhje

me qëndrimin e miqve amerikanë dhe evropianë.

"Epoka e re": Por presidenti amerikan Donald Trump kërkoi nga liderishipi kosovar të krijojë një zë unik karshi dialogut me Serbinë.

Tahiri: Që të krijohet ky zë unik duhet ta kemi mbështetjen e sovranit dhe askush më shumë se ShBA-ja nuk e mbështet një koncept politik që transmeton zërin e qytetarëve të Kosovës.

Në këtë kuptim edhe qëndrimi i LDK-së është në të njëjtën vijë me qëndrimin e ShBA-së. Duhet ta kemi një zë unik të popullit dhe jo një zë unik të pazareve në Kuvend të dy-tre individëve.

"Epoka e re": Z. Tahiri, si e shihni arritjen e marrëveshjes finale me Serbinë dhe a do të votojë LDK-ja këtë marrëveshje?

Tahiri: Ekipi negociator nuk ka legjitimitet, pra nuk e ka mbështetjen qytetare. PSD-ja ka

hyrë në Kuvend si Vetëvendosje. Këta nuk kanë marrë mandat për të negociuar në formën se si janë duke u sjellë. Nuk mund të pretendojnë se kanë legjitimitet vetëm se kanë ulëse në Kuvend. Nuk mund të flasim tani për situata hipotetike nëse do të vinte apo jo një marrëveshje e tillë. Ekipi negociator nuk ka kapacitete për t'i sjellë Kosovës marrëveshje të dobishme. Por, mund t'i sjellë vetëm një marrëveshje të dëmshme.

DIALOGU



Kadri VESELI

Gjatë vitit që po e lëmë pas kemi humbur shumë kohë duke bërë me gisht drejt njëri-tjetrit për problemet dhe çështjet që janë përgjegjësi e përbashkët e të gjithë spektrit politik. I gjithë debati politik, për fat të keq, është mbizotëruar nga një garë absurde e etiketave negative. Publiku dhe qytetarët, me të drejtë, janë ndjerë të lodhur nga spektakli i përditshëm i akuzave partiake dhe nga ndjesia se konsensusi politik është i pashpresë. Kjo ndjesi duket se u hoq ditë më parë kur në Kuvendin e Kosovës, me një unanimitet të plotë, kaluam tri ligjet e transformimit të FSK-së në ushtri të Kosovës. Vendimmarrja për ushtrinë është dëshmi se spektri politik kosovar ka gjithë forcën e duhur për t'i dhënë shans konsensusit të brendshëm për çështjet e interesit nacional, mjafton që të frenohen egot personale. Në këtë frymë u ndërmor iniciativa parlamentare për rezolutën e propozuar nga PSD-ja, përmes të cilës u krijua delegacioni shtetëror, i cili do të përfaqësojë Kosovën në dialogun me Serbinë. Delegacioni do të bashkëdrejtohet nga një përfaqësues i koalicionit qeverisës, një përfaqësues i PSD-së dhe është menduar të jetë gjithëpërfshirës, marrë parasysh traditën pozitive që kemi krijuar nga Rambujeja deri në shpalljen e pavarësisë. PSD-ja, si parti opozitare, arriti në fund të vendosë interesat nacionale mbi dëshirat e ngushta partiake. Kam besuar se më në fund edhe

dy partitë tjera opozitare, LDK-ja dhe Lëvizja Vetëvendosje, do të ecin në të njëjtin drejtim, duke menduar se janë pjekur të gjitha kushtet që të bëjmë atë për të cilën jemi zgjedhur: veprimin e përbashkët në të mirë të vendit. Nisur nga kjo, për të mërkurën që vjen, kam ftuar në Kuvendin e Kosovës, në një takim të përbashkët, presidentin, kryeministrin, ekipin negociator, si dhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare nga partitë opozitare, ende të papërfaqësuar në ekipin negociator, LDK dhe LV, që të koordinohemi për dialogun. Natyrisht për asnjë motiv tjetër, veç motivit për të ndihmuar kohezionin e brendshëm politik në raport me çështjet e dialogut me Serbinë dhe duke zgjedhur institucionin më të duhur për këtë qëllim, Kuvendin e Kosovës. Në Kuvendin e Kosovës, aty ku përfaqësohen të gjithë, sepse LDK-ja dhe LV-ja askund nuk po arrijnë të marrin vendime. Mbete pak i zhgënjyer, por jo i habitur, kur mora vesh se LDK-ja dhe Vetëvendosje, si duket në kundërshtim të ftesës sime, kanë thirrur një seancë të jashtëzakonshme, po për të mërkurën e ardhshme. Në këtë seancë, siç thuhet, do të debatohet për draft-marrëveshjen e propozuar nga Qeveria e Kosovës për dialogun me Serbinë. LDK-ja kishte vepruar njëjtë edhe me rastin e ftesës që kisha bërë për tryezë të përbashkët të partive politike, këtu e tetë muaj më parë. E pata marrë me qetësi refuzimin e tyre për të qenë pjesë e platformës së përbashkët për dialog, duke besuar se gradualisht do të kuptojnë domosdoshmërinë për të qenë pjesë e saj. Nisur nga kjo, aso kohe, iu përgjigja pozitivisht ftesës së tyre për tryezë të partive politike, edhe pse dukej qartë se krejt çfarë synonin me

to ishte balancimi opozitar i iniciativave, një synim ky krejtësisht komik dhe inatçor. LDK-ja nuk po arrin të vetëçlirohet nga politika e inatit dhe me këtë është duke i bërë dëm vendit dhe vetes, gjithsesi. Iniciativa aktuale e saj dhe e LV-së për seancë të jashtëzakonshme është e drejtë e tyre, të cilën mund ta realizojnë sa herë që plotësojnë kushtet për thirrjen e saj. Por çfarë do të arrihet me këtë seancë? Nëse duan të vazhdojnë bojkotin dhe papërgjegjësinë, gjithsesi do ta arrijnë këtë! Por a do ta ndalin Serbinë dhe ish-zëdhënësin e Millosheviqit, presidentin aktual serb, të përfitojnë tek partnerët tanë perëndimor, me përparësinë në gatishmërinë e tyre për dialog?! Vështirë të thuhet po! Një gjë dihet: Gjatë tri dekadave të kaluara, Serbia çdoherë që ka refuzuar dialogun me ne, çdo herë ka humbur! A mos duam tash ne të përsërisim gabimet e saj? Nuk e di nëse opozita, veçanërisht LDK-ja, sa është duke e kuptuar çfarë dëmi po i shkakton vendit! Seanca e jashtëzakonshme e thirrur prej tyre, në thelbin e saj, është vetëm një lojë teatrore e manipulimit me qytetarët, me një skenografi në të cilën koalicionit qeverisës i kanë ndarë rolin e "ndarësve të Kosovës", ndërsa për vete ka ruajtur rolin e "shpëtimtarëve të saj". Isa, Avdullahu, Albini, Glauku, kanë marrë "rolin e shenjtë" për të shpëtuar Kosovën nga presidenti, kryetari i kuvendit, kryeministri, z. Limaj, z. Ahmeti, etj. Kush e beson këtë farsë politike opozitare? Këtë imoralitet politik, do të thoshin ata që kërkojnë respektimin e një kodi etik në politikë. As vetë LDK-ja dhe LV-ja nuk e besojnë, por qëllimin e kanë që të manipulojnë qytetarët për

llogari meskine partiake. Pra, që me anë të kësaj seance, në përfundim të këtij viti, të bëjnë edhe pak propagandë partiake për veten. Patjetër që kjo dëshirë do t'u plotësohet, por ky plotësim do t'u kthehet bumerang nga qytetarët, sepse partitë të cilat, në vend të përgjegjësisë shtetërore, zgjedhin propagandën për veten, nuk mund të gjejnë asnjëherë përkrahjen e publikut dhe zgjedhësve. Propaganda pa punë konkrete është shërbim i keq ndaj vendit. Partitë që, në vend të përgjegjësisë shtetërore, zgjedhin propagandën e lirë për veten, me mendimin se përfitojnë vota tek zgjedhësit duke i frikësuar me idenë e re me të ndarjes së Kosovës, flasin qartë se nuk brengosën fort për proceset e mëdha të vendit e të shtetit. Ky është pozicioni i patriotizmit të rrejshëm. Po të brengoseshin përnjëmend, do të kërkonin me ngulm që të zënë vendin që u takon aty ku vendoset për këto procese. LDK-ja dhe Lëvizja Vetëvendosje nuk e bëjnë këtë, sepse, gabimisht dhe verbërisht, besojnë se ne të tjerët, do të marrim vendime të gabuara historike, prej të cilave ato pastaj do të përfitojnë politikisht. Pra, e tëra është një llogari për ardhje në pushtet. Jo më kot, ditë e natë, bëjnë thirrje për zgjedhje, madje edhe në kushtet kur e dinë qartë se do t'i humbasin ato, kurdo që do të mbahen. Gjithsesi mund të vazhdojnë të vrapojnë pas këtyre kalkulimeve partiake. Por, i siguroj se kanë për t'u zhgënjyer në fund, kur do ta kuptojnë se kanë qëndruar në anën e gabuar të historisë. Historia nuk bëhet duke folur, dhe as duke ikur nga përgjegjësia! Delegacioni shtetëror për dialogun me Serbinë dhe gjithë faktorët tjerë të ndërlidhur me këtë dialog, nuk janë duke ecur në rrugë pa

krye, aq më pak të motivuar nga ndonjë interes që bie në kundërshtim me interesin shtetëror të Kosovës. Ne veprojmë mbi një platformë, e cila u qëndron besnikërisht parimeve kushtetuese të vendit dhe kemi qëllime të qarta, të cilat duam t'i arrijmë me anë të dialogut. Në shkojmë në dialog me Serbinë për ta fuqizuar Kosovën. Nuk do të ketë rezultat tjetër në finish të tij. Dialogu nuk është favor i yni për Serbinë. Është pashmangësi e faktit se Serbinë e kemi fqinj tonë verior dhe vazhdojmë të kemi mosmarrëveshje thelbësore me të. Këto mosmarrëveshje duhet të zgjidhen, për të mos u lënë brezave që do të vijnë barrën e të kaluarës sonë të hidhur. Ne nuk kemi frikë as nga dialogu, as nga Serbia, dhe as s'kemi pasur ndonjëherë! Sovraniteti dhe integriteti i shtetit të Kosovës janë dhe do të mbesin të paprekshëm, para dhe pas dialogut. Kush do që e thotë të kundërtën është ose një gënjeshtar i madh, ose një dashakeq. Ne do të negociojmë modalitetet e mundshme përmes të cilave Serbia njeh shtetin e Kosovës dhe arrijnë e anëtarësimin të tij në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Këto dy qëllime janë të pashmangshme. Duke qenë të bashkuar, ato janë më të shpejt të arritshme. Duke qenë të ndarë, vetëm u bëjmë favore atyre që punojnë kundër arrijtes së tyre. Nuk duhet shumë mund për ta kuptuar këtë. Në shumë raste, të vërtetat e mëdha janë njëkohësisht të vërteta të thjeshta. Ne nuk e kemi ndërmend të ndalemi. Do të vazhdojmë të bëjmë atë që na e kërkon momenti historik dhe qytetarët: ta mbrojmë dhe avancojmë shtetin e pavarur e sovran të Kosovës.

Interesim i madh për procesin zgjedhor në nëndegët e PDK-së

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Në vazhdim të procesit zgjedhor që është duke u zhvilluar në tërë nëndegët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), interesimi i anëtarësisë për procesin zgjedhor, për t'i zgjedhur kryetarët e nëndegëve dhe strukturat e tjera partiake, është tejet i madh. Sipas Komisionit për zgjedhje të brendshme, procedurat dhe vijimi i procesit është plotësisht konform rregulloreve, duke u rikonfirmuar vlerat themelore të PDK-së si demokracia e brendshme dhe transparencja. "PDK-ja po rritet dhe po fuqizohet çdo ditë me kuadro e

intelektualë të shumtë që po i bashkohen. Kosovës i duhet një adresë e sigurt politike, një garanci që e zhvillon vendin dhe e integron në strukturat euroatlantike. PDK-ja është adresa më e mirë për të gjithë qytetarët pa dallim", është shprehur kohë më parë kryetari Kadri Veseli. Është inkurajues fakti se në krye të nëndegëve të PDK-së janë zgjedhur kandidatë me potencial të dëshmuar kombëtar dhe profesional si dhe përzgjedhja e grave në krye të nëndegëve. Ditët e fundit procesi zgjedhor është zhvilluar në Pestovë, Shtitaricë-Vushtrri,



Gërquinë-Has, Dubravë-Kaçanik, Mushnikovë, Gërçar, Gërdoc, Vataj-Kaçanik, Jeshkovë, nëndega në lagjen "Jarinë", "Soliter", 7 Shtatori I dhe II në Pejë,

Raushiq, Treboviq, Dardania III, Lum i madh, Dobrajë e Madhe, Bujan, Kroishtë, Ribar i Madh-Lipjan, Gllamnik-Podujevë, Davidovc-Shtime, Podujevë

Nëndega I, Qyteti II, Malësi e Re, Poslisht-Prizren, Sibofc, Kuzhnin-Has, Kuklibeg-Drageash, Kabash-Has, Bresanë, Studençan, Rogovë I dhe II, Begracë-Kaçanik, Smirë, Mitrovicë e Veriut, Kroj i Vitakut, Kodra e Minatorëve dhe "7 Shtatori", Prizren-"2 Korriku" si dhe në Kaçanik të vjetër. Të përzgjedhurit në nëndegë janë zotuar se do të angazhohen që Dekada e Re do të zbatohet në interes të qytetarëve dhe vendit, si vendimi më i mirë për t'u reshtuar krahas vlerave të PDK-së, me besim, për zhvillim dhe integrim.

Vota e Partisë Socialdemokrate (PSD) për buxhetin ka nxitur kritika ndaj këtij subjekti politik

Vazhdon përplasja Vetëvendosje - PSD

Përplasjet mes Lëvizjes Vetëvendosje dhe Partisë Socialdemokrate janë kthyer sërish në qendër të vëmendjes, pasi deputetët e kësaj të fundit votuan projektbuxhetin për vitin 2019. Lideri i LV-së, Albin Kurti, ka lëshuar akuza të rënda të dielën për ish-anëtarët LV-së, duke thënë se kanë përfunduar në prehrin e PDK-së. Duke iu përgjigjur këtyre kauzave, deputeti i PSD-së, Dardan Molliqaj, Kurtin dhe zyrtarët e tjerët të kësaj partie i ka quajtur fallxhorë të dobët



dëmtojnë Lëvizjen, sepse shumica dërrmuese e anëtarëve dhe e simpatizuesve tanë e lexuan mirë situatën dhe nuk e tradhtuan rrugën e drejtë kombëtare dhe shoqërore. Ne nuk e dinim pse ndodhi kjo, cilat ishin arsytet dhe shkaqet e qëndrimit të tyre armiqësor ndaj Lëvizjes e ndaj meje. Nuk arrinim ta kuptonim tërësisht. Mund të kishim vetëm hipoteza", ka thënë Kurti. Sipas tij, tentativën hileqare të ish-anëtarëve të LV-së, tash deputetë të PSD-së, arritën ta kuptojnë tërësisht të vërtetën vetëm të shtunën, kur në media u publikuan disa mesazhe mes deputetëve të PSD-së dhe partive në pushtet. "Ndonëse mund ta kuptosh të vërtetën si orientim, kur e kupton të vërtetën në saktësinë e përmbajtjes së saj, atëherë sigurisht se ky është zhvillim i ri. Kjo e vërtetë nuk na gëzon aspak, përkundrazi, na hidhëron. Trishtohemi që parashikimet tona po dalin të sakta, e që kush-

Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje. Ndërkaq deputeti i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka thënë se ata që vazhdimisht merren me ta nuk janë asgjë tjetër vetëm një grup i falltarëve. Në logarinë e vet në "Facebook", Molliqaj ka shkruar se zyrtarët e Lëvizjes Vetëvendosje vazhdimisht ndërrojnë arsytet kur flasin për largimin e tyre nga kjo parti. "Fillimisht, grupi i fallxhorëve të dobët thanë se ne u larguam sepse ishim spiunë të Stanishiqit. Pastaj thanë se ne u larguam sepse na kishin blerë Devollët. Më vonë thanë se arsyeja e largimit tonë ishte ndikimi i ambasadave ndërkombëtare. Dikur thanë se ne u larguam për ta votuar demarkacionin me Malin e Zi, pastaj 'zbuluan' se ne u larguam për shkak se ishim të interesuar për t'u futur në Qeveri", ka shkruar Molliqaj, duke shtuar se LV-së iu ka ndalur ora

prej se ai me shokë kanë dalë nga aty. "E sot e paskan 'zbuluar' se kemi dalë për të përfunduar në prehrin e PDK-së. Kushedi se çfarë zbulime e parashikime do të dalin tash e tutje nga grupi i fallxhorëve të dobët. Por, ajo që dihet është që kësaj partie iu ka ndalur ora qyshkur ne jemi larguar nga aty. Vazhdimisht thonë se jemi pak aktivistë, të vegjël e të parëndësishëm, por vihen shumë në siklet nëse kalon vetëm një ditë pa shpifur për neve", është shprehur ai, duke mohuar çdo mundësi të futjes në koalicionin qeverisës të PSD-së. "E ne, fatkeqësisht, do t'i zhgënjim. Përveçse nuk do të futemi në këtë Qeveri, do të angazhohemi vazhdimisht që PDK-në ta largojmë nga pushteti pas kaq shumë vjetësh keqqeverisje. Ju vazhdoni të qitni fall se, pavarësisht që parashikimet i keni të dobëta, ndoshta me kalimin e kohës përmirësoheni në këtë fushë", ka vlerësuar Molliqaj. Akuzat e Kurtit për deputetët e PSD-së kanë ardhur pasi në medie janë publikuar disa mesazhe mes Pal Lekajt, Bilall Sherifit dhe Dardan Molliqajt, të cilat kanë komunikuar të premtën përmes sms-ve gjatë seancës për projektbuxhetin. Në këto mesazhe i kërkohej Molliqajt që ta respektojë premtimin e dhënë për votim të këtij projektligji, kurse ky i fundit e konfirmonte se do ta votojë projektbuxhetin.

EPOKA ERE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, sërish ka drejtuar akuza të rënda ndaj zyrtarëve të Partisë Socialdemokrate (PSD), pasi deputetët e kësaj të fundit kanë votuar projektbuxhetin për vitin 2019. Kurti ka thënë se ata janë blerë duke përfunduar në prehrin e PDK-së. Ndërkaq përgjigja e PSD-së ndaj këtyre akuzave ka qenë e shpejtë. Deputeti i PSD-së, Dardan Molliqaj, Kurtin dhe zyrtarët e tjerë të kësaj partie i ka quajtur fallxhorë të dobët. Në mbledhjen e 35 të Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje, lideri i këtij subjekti politik, Albin Kurti, ka thënë fillimisht i këtij viti ka qenë paksa i pazakontë, sepse kjo lëvizje nuk po e kuptonte se përse një grup aktivistësh të dikurshëm u përpoqën ta dëmtojnë partinë. "Sigurisht, ata nuk ia dolën ta

dëmtojnë Lëvizjen, sepse shumica dërrmuese e anëtarëve dhe e simpatizuesve tanë e lexuan mirë situatën dhe nuk e tradhtuan rrugën e drejtë kombëtare dhe shoqërore. Ne nuk e dinim pse ndodhi kjo, cilat ishin arsytet dhe shkaqet e qëndrimit të tyre armiqësor ndaj Lëvizjes e ndaj meje. Nuk arrinim ta kuptonim tërësisht. Mund të kishim vetëm hipoteza", ka thënë Kurti. Sipas tij, tentativën hileqare të ish-anëtarëve të LV-së, tash deputetë të PSD-së, arritën ta kuptojnë tërësisht të vërtetën vetëm të shtunën, kur në media u publikuan disa mesazhe mes deputetëve të PSD-së dhe partive në pushtet. "Ndonëse mund ta kuptosh të vërtetën si orientim, kur e kupton të vërtetën në saktësinë e përmbajtjes së saj, atëherë sigurisht se ky është zhvillim i ri. Kjo e vërtetë nuk na gëzon aspak, përkundrazi, na hidhëron. Trishtohemi që parashikimet tona po dalin të sakta, e që kush-

Në 29-vjetorin e LDK-së, Mustafa ia numëron dështimet koalicionit qeverisës

EPOKA ERE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka shënuar të dielën 29-vjetorin e themelimit të saj. Me këtë rast, lideri i saj, Isa Mustafa, ka folur për ecurinë e kësaj partie dhe zhvillimet e përgjithshme në vend. "Në motin e ndryshimeve të mëdha historike që kishin përfshirë mbarë Evropën, më 23 dhjetor 1989, në ish-shtëpinë e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës në Prishtinë, u themelua Lidhja Demokratike e Kosovës, në krye me shkrimtarin dhe kritikun unik të letrave shqipe, intelektualin e urtë, presidentin historik të Kosovës, dr. Ibrahim Rugovë. LDK-ja është partia e parë e themeluar si lëvizje demokratike në botën shqiptare dhe në këtë pjesë të Evropës e të botës pas Luftës së Dytë Botërore", ka thënë Mustafa, i cili u ka kërkuar falje anëtarëve të kësaj partie pasi fjalimin e tij po e lexon ulur. "Më vjen keq që sot po ju drejtohem ulur në këtë kremtë të madhe. Ju meritoni respektin më të madh. Po mbushet gati një vit që po

ballafaqohem me rehabilitimin shëndetësor, gjatë së cilës kohë kam pasur përkrahjen nga pjesa dërrmuese e juve. Me përkrahje të familjes, të bashkëpunëtorëve të mi më të ngushtë, të njerëzve të mirë, me mbështetje në Zotin dhe në mjekët tanë të mrekullueshëm, po arrij të rikuperohem ngadalë", ka thënë Mustafa. Ai ka shtuar se sot pas 29 vjetësh nga themelimi, LDK-ja qëndron e para në Kosovë. "Me grupin më të madh parlamentar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me numrin më të madh të komunave që drejtohen nga LDK-ja, me mbështetjen më të madhe që del nga të gjitha matjet e opinionit publik. Jemi parti e parë dhe e vetme e familjes më të madhe politike evropiane, Partive Popullore Evropiane", është shprehur lideri i LDK-së. Ai ka theksuar se LDK-ja është e vendosur të luftojë dhe t'i kundërshtojë të gjithë ata që keqpërdorin vlerat demokratike të këtij vendi, që zhvatën pasurinë e Kosovës dhe që pengojnë rrugën euroatlantike të vendit tonë. Mustafa ka kritikuar punën e koalicionit qeverisës. Sipas tij, vetëm në një vit qeverisje koali-



cioni aktual qeverisës i ka shkaktuar dëme të mëdha Kosovës. "E la pa liberalizim të vizave, pa anëtarësim në Interpol, pa njohje të reja dhe me paralajmërime për tërheqje të njohjeve nga disa vende. Katër komuna të veriut të vendit kanë ndërprerë komunikimin me qeverinë se sillen se janë komuna të Serbisë, kurse Qeveria dhe institucionet qen-

drore bëjnë sehir, sikur të jenë pajtuar me këtë gjendje. Aktualisht, përkrahja ndërkombëtare e Kosovës është në nivel shumë të ulët", ka deklaruar Mustafa. Ai ka folur edhe për procesin e dialogut me Serbinë, ku ka dhënë kritika për ekipin negociator që ka votuar Kuvendi i Kosovës. "LDK-ja konsideron se armimet të cilat po përpiqen t'i bëjë koalicioni qev-

erisës, me ekipe hibride dhe jolegjitime, janë shprehje se Qeveria aktuale ka pranuar pafuqinë e saj për dialogun dhe mungesën e shumicës. Armimi me një parti, që nuk peshon më shumë se 3 për qind të besimit qytetar, nuk mund t'i shitet Brukselit si grup i unitetit me opozitën dhe as përfaqësim me opozitën", ka thënë Mustafa.

Komuna e Podujevës dhe GIZ-i bashkëpunojnë për mbrojtjen e ambientit

Podujevë, 23 dhjetor (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Agim Veliu, ka zhvilluar një takim me përfaqësuesit e GIZ-it, me të cilët ka diskutuar për planet dhe projektet e përbashkëta në fushën e ambientit. Veliu ka falënderuar përfaqësuesit e GIZ-it për bashkëpunimin e suksesshëm në sferën e ambientit, duke ofruar bashkëpunim më të thellë për avancimin e projekteve që mundësojnë menaxhim më të mirë të mbeturinave. Ai ka thënë se Komuna e Podujevës ka formuar grupin punues për menaxhim të mbeturinave, i cili do të punojë për ndarjen e zonave të shërbimit, si dhe do të angazhohet për largimin e deponive ilegale dhe shtrirjen e sistemit të grumbullimit të mbeturinave.

GIZ-i ka angazhuar dy kompani, një për plan të ri operativ për shërbim dhe një kompani tjetër për përcaktimin e tarifave të grumbullimit të mbeturinave.

Shqetësimi që u ngrre në këtë takim ishte iniciativa e Kompanisë për Menaxhimin e

Deponive në Kosovë (KMDK), e cila ka kërkuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE) rritjen e tarifave të deponimit të mbeturinave.

Për këtë çështje kryetari Veliu ka thënë se kjo iniciativë është kundërshtuar edhe në Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) për faktin se, nëse ndodh kjo rritje e tarifave, krijon vështirësi të shërbimit të amvisërive. "Fokusi ynë duhet të jetë për përmirësimin e shërbimeve dhe menaxhim më të mirë të deponive, e jo ngritja e tarifave", ka thënë Veliu.

Në takim është diskutuar edhe për planin e ri operativ për shërbime, i cili do t'i përfshijë të gjitha vendbanimet e komunës. Ky plan do të jetë më eficient në shpenzime dhe mundëson shfrytëzim maksimal të aseteve teknike dhe humane. GIZ-i i ka dhuruar kompanisë "Pastrimi" 50 kontejnerë të cilët do të shërbejnë për riorganizimin e mbeturinave përgjatë qendrës së qytetit, si dhe 200 kontejnerë 60 litërsh të cilët do të shpërndahen për amvisëritë në fshatin Batllavë.



Susuri: Nuk lejojmë organizimin e ekskursioneve të nxënësve në mënyrë të jashtëligjshme

PRIZREN, 23 DHJETOR (ER) - Drejtori i Arsimit në Komunën e Prizrenit, Skënder Susuri, ka reaguar në lidhje me protestën që kanë bërë një grup i nxënësve të shkollave të mesme, të cilët e kanë akuzuar atë për ndalim të ekskursionit të tyre në Brezovicë. Ai ka thënë se ky ishte një organizim i jashtëligjshëm, i planifikuar nga një grup nxënësish të manipuluar nga individë apo grupe përfituesish, me qëllime materialiste dhe të dëmshme për sigurinë dhe shëndetin e

nxënësve.

Drejtorja Komunale e Arsimit (DKA) në Prizren ka njoftuar me kohë se ky organizim nuk do të lejohet por nxënësit, përkundër këtij njoftimi, janë mbledhur në stacionin e autobusëve në Prizren, duke insistuar për t'u nisur drejt Brezovicës. "Policia e Kosovës, në mbështetje të kërkesës së DKA-s, për ndalim të këtij organizimi të jashtëligjshëm, e pamundësoi një organizim të tillë. Nuk është ndaluar një 'ekskursion i nxënësve', siç

shkruhet në disa media elektronike (me qëllim apo pa qëllim), por është ndaluar një organizim i paligjshëm dhe i rrezikshëm për sigurinë dhe shëndetin e fëmijëve/nxënësve", është thënë në komunikatën e DKA-s, e cila mban emrin e Skënder Susurit. Kjo drejtori ka paralajmëruar se edhe në të ardhmen do të parandalonjë aktivitete të tilla të jashtëligjshme dhe të dëmshme për sigurinë e nxënësve.



Komuna e Drenasit vazhdon me projektin për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit

DRENAS, 23 DHJETOR (ER) - Komuna e Drenasit, përkatesisht Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, ka vazhduar projektin e ndriçimit publik edhe në zonat urbane, përkatesisht para

institucioneve në fshatin Arllat dhe Gllanasellë. Ky lloj i ndriçimit është modern dhe pas orës 00:00 deri në mëngjes ka intensitet më të ulët që të kursëhet energjia elektrike. Drejtoresha e

Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, Lumnije Krapa, ka theksuar se do të vazhdojnë me projekte të tilla në mënyrë që t'ua lehtësojnë jetën të gjithë qytetarëve të Komunës së Drenasit.

Dhurohen 57 lopë qumështore për fermerët e Ferizajt

FERIZAJ, 23 DHJETOR (ER) - Në vazhden e projekteve mbështetëse në fushën e blegtorisë, Drejtorja e Bujqësisë në Ferizaj u ka ndarë lopë qumështore 57 fermerëve nga kjo komunë. Një ndër përfituesit është fermeri Avdyl Karaliti nga fshati Dardani, të cilit kohë më parë i tërë fondi blegtoral i është vjedhur nga persona të panjohur. Me këtë rast, ai ka falënderuar Komunën e Ferizajt për përkushtimin që po tregon për përkrahje me lopë qumështore.

Karaliti ka shpjeguar se ky donacion do të ndikojë në ekonominë e tij familjare. Në anën tjetër, i pari i Drejtorisë së Bujqësisë, Burim Bajrami, ka thënë se ky projekt është i komunës. Sipas tij, kjo është faza e parë e dhurimit të



lopëve qumështore.

Bajrami ka treguar se të gjithë përfituesit përbëjnë një kategori të veçantë të fermerëve, ndërsa ka bërë me dije se projekti ka kushtuar 70 mijë euro, plus participimi në masën prej 25 përqindësh nga përfituesit. Bajrami ka theksuar se interesimi për të qenë në listë ka qenë tepër i madh. Sipas tij, ky interesim ka bërë që të ndryshojë edhe vendimi i ekzekutivit me qëllim që përfitues të jenë një numër më i madh i fermerëve.

A do të ketë ndëshkime të reja financiare për autostradën Prishtinë - Shkup?



PRISHTINË, 23 DHJETOR - Autostrada që lidh kryeqytetet e Kosovës dhe Maqedonisë, përkatesisht Prishtinën dhe Shkupin, ishte paraparë të përfundonte në fund të këtij viti. Por, në bazë të paralajmërimeve, lëshimi në qarkullim i kësaj autostrade mund të shkojë përtej këtij afati. Që nga fillimi i ndërtimit në korrik të vitit 2014, nga kompania ndërtuese është paralajmëruar se autostrada do të jetë e gatshme për qarkullim në fund të vitit 2018. Por, nga punët në terren zyrtarë të Qeverisë nuk shpresojnë se punët mund të përfundojnë gjatë 10 ditëve të mbetura të këtij viti. Konsorciumi turko-amerikan "Bechtel-Enka" është kompania e cila po ndërton këtë autostradë. "Radio Evropa e Lirë" ka bërë përpjekje të marrë një konfirmim nga përfaqësuesi i konsorciumit se kur mund të përfundojë projekti, por nuk është përgjigjur për ndonjë konfirmim të mund-

shëm. Ndryshe, ky konsorcium është i njohur në Kosovë, pasi paraprakisht ka ndërtuar edhe autostradën që lidh Kosovën dhe Shqipërinë. Rexhep Kadriu, zëvendësministër i Infrastrukturës në Qeverinë e Kosovës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se punët në autostradën Prishtinë - Shkup, e quajtur "Arbën Xhaferi", po vazhdojnë me dinamikën që po lejojnë kushtet klimatike. Por që, sipas tij, mundësitë janë të vogla që punët të përfundojnë deri në fund të këtij viti, ashtu siç parashihet në kontratë. "Në autostradën Prishtinë - Shkup është duke u punuar me intensitet të shtuar. Është montuar trari i fundit i urës. Sipas dinamikës që jemi duke parë në terren, vështirë se mund të përfundohet për arsye se nuk guxojmë të rrezikojmë urën më të gjatë në Ballkan për asfaltim sepse nuk lejojnë kushtet atmo-

ferike për asfaltimin e saj", ka thënë Kadriu. Edhe Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka thënë se projekti nuk do të përfundojë brenda këtij viti për shkak të kushteve atmosferike. Këto komente ai i ka bërë të enjten në një vizitë inspektuese në punimet që janë duke u zhvilluar. Megjithatë, Lekaj ka kërkuar nga kompania kontraktuese që punimet e mbetura të realizohen me standarde të larta. Çështja e autostradës Prishtinë - Shkup ishte në qendër të vëmendjes këta tre muajt e fundit, pasi që Qeveria e Kosovës kishte vendosur t'i paguante kompanisë "Bechtel-Enka" një shumë prej 53 milionë eurosh për shkak të mospagesës së rregullt të faturave. Vendimi për ndarjen e këtyre mjeteve kishte nxitur debate dhe dyshime nga partitë opozitare dhe shoqëria civile, kurse kryeprokuroria dhe Policia e Kosovës kanë nisur hetimet. Ato kanë bërë

të ditur se janë duke mbledhur të dhëna lidhur me ndarjen e 53 milionë eurove për konsorciumin "Bechtel-Enka". Një gjohë e tillë, të cilën e kishte paguar buxheti i Kosovës, ka nxitur më pas reagime se a mund të ketë ndëshkime edhe për "Bechtel-Enka" nëse nuk i kryen punimet sipas planifikimeve. Rexhep Kadriu nga Ministria e Infrastrukturës, thotë se janë duke shqyrtuar kontratën bazë me kompaninë ndërtuese për masat eventuale që mund të merren në rast të mosrealizimit në kohë të projektit. "Ne jemi duke shqyrtuar kontratën bazë që kemi me 'Bechtel Enkan' dhe opinioni do të njoftohet në kohën e duhur për masat që do të marrë Qeveria e Republikës së Kosovës", është shprehur Kadriu. Ndërsa Qeveria thotë se po shqyrtton masat që mund të ndërmerren, organizatat joqeveritare rikujtojnë se kontrata e lidhur midis

Qeverisë dhe "Bechtel-Enkas" nuk është bërë asnjëherë publike, andaj edhe nuk dihen detaje nëse parashikohet ndonjë masë ndëshkuese. Genc Nimoni nga Lëvizja "Fol" thotë për "Radion Evropa e Lirë" se është vështirë të jepet një konstatim i saktë në mungesë të kontratës por, sipas tij, duhet të ketë masa ndëshkuese për kompaninë nëse nuk përfundon punën në afatin e paraparë. "Ne nuk e kemi parë kontratën me kompaninë fituese. Mund të them se është një ndër kontratat më kontroverse. Por, pavarësisht kësaj, kontrata duhet të ketë penalltitë në rast të vonesave për realizimin e punëve, normal që duhet të pasojë llogaridhënia dhe ndëshkimi për kompaninë", vlerëson Nimoni. Autostrada Prishtinë - Shkup, e quajtur "Arbën Xhaferi", me gjatësi prej 60 kilometrash, buxhetit të Kosovës do t'i kushtojë 600 milionë euro.

Lëshohet në qarkullim pulla postare "Dëshmorët e Gjakovës"

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, me ndihmën e qytetarëve të Gjakovës, kanë përzgjedhur dizajnin e preferuar të pullës postare me temë "Dëshmorët e Gjakovës". Nga e shtuna kjo pullë postare është lëshuar në qarkullim. Shoqata e Intelektualëve të Gjakovës ka dhënë një përshkrim rreth pullës postare "Dëshmorët e Gjakovës":

Shoqata e Intelektualëve "Jakova" e përshëndet programin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, përkatesisht ministrit Valdrin Lluka, që ka vënë në veprim edhe projektin me titull Pulla Postare "Dëshmorët e Gjakovës". Këto pulla postale janë dëshmi e përhershme për ta sjellë në kujtesë dhe për të mos i harruar vitet 1989/1990 dhe të gjitha ato që ka përjetuar popullata

shqiptare e Gjakovës dhe e fshatrave të Gjakovës dhe jo vetëm, si flakët e luftës dhe viktimat në betejat, dëbimin e banorëve nga fshatrat, strehimin në familjet e Gjakovës, ndihmat dhe shpresën për liri. 20 vjet më parë, kur lufta përfshiu edhe këtë pjesë të Kosovës, ishte rinia gjakovare ajo e cila u mobilizua në masë, e gatshme për ta shprehur përkushtimin për sakrificë. Me këtë projekt

unik ministria e ka realizuar qëllimin që të shënojë dhe të lërë gjurmë të zhvillimit historik të ngjarjeve, të situatave tepër të rënda, të angazhimeve, të veprimtarisë së personave dhe të familjeve të këtij nënqielli. Këto të gjitha janë realizuar duke paraqitur në mënyrë simbolike dhe besnikërisht, pa zbulime e lavdërime të tepruar në pullën postare "Dëshmorët e Gjakovës"...



Koha e Ramush Haradinajt



Bedri ISLAMI

Më shumë se dy dekada më parë e kam njohur Ramush Haradinajn. I vrullshëm si gjithnjë dhe kërkues deri në fund, atij i kanë mbetur ende këto dy tipare, ndër më kryesoret në jetën e tij.

Dy nga domosdoshmëritë e një burri shteti që, edhe në secilën ditë, por sidomos në momente të veçanta shfaq shumë nga vetja, ndoshta më shumë nga se ishte menduar dhe ripërsëritet nga ajo që ka bartur në shumë vite.

Kur e kam njohur fillimisht ai sapo ishte kthyer nga njëra ndër përpjekjet më të vështira të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, maj 1997, kur dhjetë vetë, mes tyre edhe Luan Haradinaj, shefi i logjistikës së UÇK-së, do të niseshin për të hyrë në Kosovë, për të shtrirë përmasat e luftës që do të vinte së shpejti, në të gjithë viset.

Luani, i vëllai, ishte vrarë në kufi, në pritën e shërbimit sekret dhe të milicisë serbe. Katër shokë të tjerë ishin plagosur. Prita kishte qenë e rëndë dhe, për fat, vetëm vendimi për të shmangur rrugën që i kishin thënë, do t'i shpëtonte të tjerët. Katër orë barti mbi shpatulla trupin e të vëllait, duke i thënë "hajt, djalë, mos bëj lojna, mos u çart", si të donte të mos e besonte as vetë se ishin ndarë, ashtu si nuk e besonte as një vit e gjysmë më vonë, kur përsëri në luftë, do t'i vritej vëllai tjetër, Shkëlzeni.

Ramush Haradinaj është për të dytën herë kryeministër i Kosovës. Në mandatin e tij të parë më ftoi të isha këshilltar i tij politik dhe ishte hera e parë që pranova një detyrë shtetërore. Megjithëse periudhë e shkurtër, ka qenë gjithnjë gjë e veçantë të punoje me të, të shihje se si një njeri i luftës po prishte murin që ishte ngritur mes luftëtarëve dhe krahut të paqes, se si, bashkë me Rugovën po krijonin një lëvizje të re politike, megjithëse njëri, kryeministri, e kishte me gjithë mend, ndërsa tjetri synonte të largonte sa më larg nga pushteti rivalin e tij, Thaçin.

Mandati i parë i Haradinajt u ndërpre. Akuzat serbe kishin bërë punën e tyre dhe, për më tepër, kishin gjetur në Hagë një njeri që, edhe kur kishte në Zvicër postin e Prokurores së Përgjithshme, Karla del Ponte, do të ishte zyrtarja e vetme e Evropës që ishte hapur kundër luftës në Kosovë. Një funksionare e mllëfosur, që pezmin e saj e shprehu edhe më tej kur u

largua nga posti, përmes një libri që askush nuk e mori më pas seriozisht.

Në Hagë, dy herësh, Ramushi ishte mbi akuzën serbe dhe mbi dëshirën e del Pontes. Humbi jo pak vite, por si kishte ndodhur edhe më herët, nuk u thye. Njeriu që kishte hyrë në luftë me pseudonimin "Smajli", në nderim të xhaxhait të tij Smajl Haradinaj, një i burgosur politik i njohur dhe drejtues i Komitetit të Deçanit, të gjithë profesorë, pas dy gjykimeve, u kthye në Junik si njëri ndër ata që do të përipiqej të bënte edhe më tej atë që kishte ëndërruar: pjesën e tij në formatimin e shtetit të Kosovës.

Tani është koha e kryeministrit të Kosovës, Haradinaj. Nuk është koha hakmarrëse e tij, por koha vendosëse e një njeriu që shpirtin e kishte mbushur me besim dhe që, po e ndjente se, pa dashjen e tij, shpirti po i zbrapset.

Ramush Haradinaj është një burrë që, kur ndahesh prej tij, mos e kthe kurrë kokën pas. Ndryshe nga disa të tjerë, ai nuk të pret kurrë në besë, nuk të thotë një fjalë për një tjetër, të bën vend dhe të afron gjithë çka është e nevojshme në një barazi jetësore. E kam njohur dhe e kam takuar në momente të vështira, ashtu si edhe në kohën e tij.

Ditët e fundit Qeveria e Kosovës ndërmoi tri akte të një rëndësie kapitale. Dërgoi në Kuvend dhe Kuvendi i Kosovës e miratoi me votat e gjithë deputetëve, të shumicës dhe të opozitës, duke përjashtuar Listën Serbe, një grupim politik me kokën në Beograd, ligjin për krijimin e Ushtrisë së Kosovës. Kjo ka qenë ëndrra e një generalit, ndër më të merituarit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Edhe pse e dinte se do të kishte reagime të pandashme nga Bashkimi Evropian, ai vendosi që mallrat serbe, të cilat kishin gjetur një treg me përfitime milionash në Kosovë, pa shlyer asnjë detyrim, të taksohen në masën 100 për qind.

Duket si një masë radikale, e bërë në zemërim e sipër, ndërsa në fakt nuk është asgjë tjetër veçse mbyllja e dyerve të një matrapazllëku financiar e politik, që hiqte nga buxheti Kosovës rreth 40 milionë euro në muaj. Në një vit më shumë se gjysmë miliard euro. Për një shtet si Kosova kjo nuk është pak.

E gjithë qeveria serbe u trondit, pasi deri asaj dite, jo vetëm që nuk kishin marrë parasysh partneritetin mes dy shteteve, por edhe e kishin përbuzur idenë se mund të ishin të barabartë. Të mësuar me përkëdheljen pas goditjes dhe një farë "pendese" të ndonjë shteti evropian, qeveria serbe mendoi se përgjigja e njeriut dorë hekur në Kosovë mund të ishte një lojë politike e çastit, ndaj në fillim e morën me

qesëndi, pastaj erdhën duke u rrudhur, vazhduan të inatosen, të bëjnë llogari për humbjet që kishte ekonomia serbe, jo vetëm financiare, por edhe politike, kjo ishte më e rëndë, dhe, shpërthyen.

Kryeministria serbe ishte ajo që turfulloi më shumë, sepse do të ndeshej jo me kokëfortësinë e një burri shteti, por, për më tepër, me qetësinë e tij, e cila, si nuk e kishin pritur, ishte bërë edhe shkak i dytë i zemërimit të tyre.

Ajo trokiti në të gjitha dyert, të cilat edhe i hapeshin, por edhe pop i mbyllen. trokiti edhe në Shqipëri, ku gjeti një portë të mbyllur, për më tepër, e gatshme të hapej vetëm për gjithçka kishte nevojë Kosova.

Pas saj turfulloi presidenti serb, njeriu që gjatë luftës në Kosovë, kur Haradinaj ishte drejtuesi i Zonës Operative të Dukagjinit, bënte detyrën e korrierit të birrës tek një kriminel lufte si Sheshel, apo, ndiqte me adhurim bastisjet dhe vrasjet serbe në Kosovë.

Ishte menduar se Kosova është e pagojë dhe e braktisur në vetminë e saj. Presidenti serb hodhi dorashkën, të cilën, askush në Kosovë nuk guxon ta marrë për të bërë zbutjen e dëshiruar serbe.

Kërkesa e Qeverisë së Kosovës është e qartë, e thjeshtë dhe e kuptueshme. Ne jemi dy shtete

që bëjmë bisedime, takohemi, flasim, ngritim grupe pune, mund të diskutojmë për shumë gjëra, por nuk njihemi. Mes atyre që nuk njihen gjërat janë të ndara.

Me gjithë presionin e zyrtarëve të lartë të Bashkimit Evropian gjendja nuk ka ndër mend të ndryshojë.

Për më tepër, krejt hapur dhe pa asnjë dorezë, shefi i Qeverisë së Kosovës, u dha mesazhin se investimi i shumë viteve i saj po humbet peshën dhe vlerën në Kosovë, e cila është mirënjohëse, por nuk e kupton përse, pikërisht kjo bashkësi evropiane, ku është shpresa e banorëve të Kosovës, sillet mes dy standardeve dhe ku, edhe një herë, i përgjakuri dhe i vrari kërkohet të bëjë fajtorin dhe të ulë kokën.

Tani Haradinaj po shtron një gjë të pamenduar nga strukturat serbe.

Ai po përgatitet të kërkojë diçka që duhej të ishte bërë 20 vite më parë: dëmshpërblimin për krimet serbe në Kosovë dhe ky dëmshpërblim, i llogaritur si mundësia më e vogël është 22 miliardë dollarë.

Gazeta beogradase, "BLIC", shpërtheu menjëherë se, Haradinaj kërkon shkatërrimin e Serbisë.

Në fakt është më e vogla që mund të kërkohet. Të mos harrohet se, veç dëmshpërblimit

për mijëra e mijëra shtëpi të djegur, mbi 12 mijë të vrarë, disa qindra ende të zhdukur, është bërë një grabitje e pashembullt në fundin e shekullit të shkuar, por ajo që ende nuk është llogaritur qëndron në kontributet pensionale që qindra mijëra shqiptarë të Kosovës kanë derdhur në bankat Jugosllave, sidomos në JUGOBANK, dhe nga të cilat nuk kanë përfituar asgjë.

Koha ka ardhur për të llogaritur edhe ato. Kosova dhe Serbia janë para një ndeshje të re, kësaj here në një tryezë ku askush nuk është më i rëndësishëm se tjetri, por ku njëra palë ka ende për të shlyer. Ajo nuk duhet të vazhdojë me turfullime, spekulime dhe dëshirën për të tërhequr nga vetja territore të pastra shqiptare.

Ajo duhet të mësojë, edhe pse pas kaq shumë viteve, të kërkojë së pari, falje.

Koha e Kosovës ka nisur edhe një herë dhe mbi këtë fillësë edhe mund të bisedohet.

Koha e shtetit serb ka ngecur. Koha e Kosovës ka nisur edhe një herë.

Një gjeneral i dikurshëm e risolli, jo si shenjë lufte, por si një fillësë paqe dhe marrëveshje të veçantë dhe të domosdoshme.

I dashur kryeministër i Kosovës dhe mik i vjetër: kjo është koha e Kosovës dhe këtë kohë shqiptarët e lidhin me emrin tënd!



Narkoza e vizave - mit apo realitet (3)



Shkruan: Agron HOTI

Ndjenja ani-Kosovë

Njëri ndër kryeadministratorët e parë të Misionit të OKB-së në Kosovë, më vonë edhe ministër i Jashtëm i Francës, Bernard Kouchner, në vizitën që i pati bërë familjes Jashari, pati deklaruar me empati se "po të kishte çmim Nobel për liri e sakrificë, pa dyshim se ai do t'i takonte familjes Jashari". Pra, narrativi i Kosovës pas luftës ishte tejet pozitiv, human dhe shumë të huaj që punonin në Kosovë e kishin të njëjtën frymë. Por, kjo, fatkeqësisht, filloi të ndryshojë, sidomos pas trazirave të marsit 2004, kur Kosova para botës paraqitej si dëmtuese e trashëgimisë kulturore serbe në Kosovë. Serbia, së bashku me Rusinë dhe aleatë të tjerë, ia dolën të krijojnë një sentiment anti-Kosovë, duke theksuar elementin fetar dhe terrorizmin si pika që shqiptarët e Kosovës i bënë të rrezikshëm për sigurinë e Evropës. Madje, edhe përfaqësues të BE-së në Kosovë patën filluar të artikulojnë ndryshe nga ajo që, në fakt, ishim dhe meritoni. Kjo, fatkeqësisht, as sot nuk është më ndryshe.

Për më tepër, Rusia përmes mekanizmave të vet gjithandej Evropës, së bashku me Serbinë dhe miqtë e saj, kanë krijuar një sentiment anti-Kosovë që nuk ka asnjë bazë, por që, fatkeqësisht, është realitet. Pra, Serbia, edhe pse mbi 100 vjet ka terrorizuar dhe gjenociduar shqiptarët e Kosovës, ka sot narracion më të mirë në Evropë sesa Kosova, e cila ka luftuar për ndjenjën më humane dhe fisnike që njeh njerëzimi e që është çlirimi nga pushtimi klasik, pra çlirimi nga Serbia. Këtë narracion negativ për Kosovën janë duke e ushqyer rregullisht Rusia, Serbia dhe aleatët e tyre gjithandej globit.

Ky angazhim anti-Kosovë nga ky aktor joevropian (Rusia) bashkë me Serbinë e kanë për qëllim që brenda Kosovës të krijojnë kaos e pasiguri, në mënyrë që Kosova të paraqitet para Perëndimit dhe botës si shtet i dështuar. Dhe në këtë pikë, nuk është se nuk i është bërë dëm Kosovës nëse i referohemi mosnjohjes së pavarësisë së Kosovës nga pesë shtete anëtare të BE-së, bllokadës ruse (dhe aktorëve të

tjerë) në Këshillin e Sigurimit me qëllim të pamundësimit të Kosovës për t'u anëtarësuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe mekanizma të tjerë ndërkombëtarë.

Përpos kësaj, ky aktor joevropian, pra Rusia, me qëllimin parësor të tij, futjen e përçarjes anembanë BE-së, investon në destabilizimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor siç ishte rasti i tentimpuçit në Mal të Zi, dështimi i referendimit në Maqedoni për ndryshim të emrit, hapja e qendrës 'hulumtuese' ruse në Nish të Serbisë, përfshirjet e maskuara në veri të Kosovës dhe obstrukcione të tjera të dukshme dhe të fshehta.

E Serbia, edhe pse me dy fytyra, njëren kah BE e tjetrën kah Rusia, asnjëherë nuk u kritikua nga BE-ja, madje ajo qysh moti gëzon liberalizimin e vizave, pa marrë parasysh obstrukcionet e vazhdueshme që i bën në Kosovë, Bosnje, Maqedoni e Mal të Zi. Megjithatë, shteti i Kosovës ka vazhduar konsolidimin e brendshëm dhe të jashtëm të tij pa marrë parasysh sfidat dhe vështirësitë me të cilat është përballur dhe ende përballat. Pra, Serbia eksporton në Kosovë mbi 500 milionë euro në vit dhe, në anën tjetër, nuk lë gurë pa lëvizur për ta dëmtuar Kosovën në të gjitha drejtimit e mundshme. Ndërkohë, BE-ja as edhe një herë të vetme nuk merr masa sanksionuese ndaj Serbisë, si shteti që së bashku me Rusinë përdor çdo mjet të mundshëm për ta sjellë projektin evropian buzë greminës. Obstrukcionet e Serbisë ndaj konsolidimit të shtetësisë së Kosovës janë duke u mbështetur nga Rusia. Kjo e fundit ka frikë se mos Serbia do të arrijë marrëveshje me Kosovën, pastaj të avancojë në rend-ditën evropiane. Pra, Rusia nuk është e interesuar për zgjidhje të problemit të Kosovës, por për tejzgjatjen e tij në interes të shtetit rus.

Ndërkohë Kina, përpos investimeve multimiliardëshe, ka filluar të paguajë politikanë të ndryshëm të vendeve të BE-së, sidomos ata të Evropës Lindore dhe Jugore që haptazi llobojnë për interesat kineze në BE. Për më tepër, Kina ka ndërmarrë mega-iniciativa globale të cilat si synim parësor kanë qasjen, ndër të tjera, në tregje të Evropës, aspekt ky tejet sfidues për ekonomitë në krizë të BE-së.

Pra, shumë politikanë të BE-së, siç ishte edhe Stefan Fyle, ish komisionari i BE-së për Zgjerim, sot janë duke punuar haptazi në favor të interesave kineze dhe këtë është duke e bërë përmes gjigantit kinez CEFC për energji që, sipas gazetës "Economist",

është e lidhur me inteligjencën ushtarake kineze.

Pra, ka edhe shumë zyrtarë të tjerë çekë e, besa, edhe hungarezë, që janë vënë plotësisht në funksion të interesave kineze, duke dëmtuar kështu rëndë projektin evropian ku Kosova synon të anëtarësohet. Nuk është e rastësishme që Kina preferon marrëveshje bilaterale me shtete anëtare të BE-së përpara atyre multilaterale. Kjo sepse Kina në raporte bilaterale demonstroi fuqi dinozaureske përballë çdo shteti anëtar të BE-së. Nuk janë të rastësishme flirtimet e vendeve të Evropës Lindore me megaprojektet e mëdha kineze të cilat vetëm një qëllim kanë: depërtimin e plotë, nëse jo edhe dominimin në tregun e brendshëm të BE-së.

Rritja e ndikimit të Kinës është duke u bërë e dukshme edhe në fushën e zhvillimit dhe inovacionit, ku Kina në vitin 2016 kishte bërë një plan për rritjen e investimeve në hulumtime dhe zhvillim. Jorastësisht sot Kina jep 233 miliardë dollarë në vit për hulumtime dhe zhvillim që përbën 20 për qind të totalit global për këto investime. Duke u përqendruar në tri fusha kryesore (gjysmëpërçues, kompjuterë quantum dhe inteligjencë artificiale) pritet që Kina deri në vitin 2030 ta dominojë botën në inteligjencë artificiale. Nuk është e rastësishme

që, sipas "World Economic Forum", 20 firmat më të mëdha globale të IT-së dhe internetit janë nga Kina dhe ShBA-ja, pra nuk ka as edhe një firmë të vetme evropiane në këtë mes. Prandaj, Kina është duke investuar gjithandej globit, përfshirë Evropën, për ta shtyrë përpara agjendën e vet ekonomike globale.

Në anën tjetër, rajoni i Ballkanit Perëndimor është duke u ndikuar çdo ditë e më shumë nga synimet e Turqisë për t'u konsoliduar si fuqi rajonale në Ballkan. Mjafton t'i shohim investimet turke në Ballkan dhe të bindemi për këtë. Ndërkohë që, BE-ja me Turqinë ka ndërtuar Union Droganor, i cili, për hir të vërtetës, është duke funksionuar pa vështirësi. Pra, neve në Kosovë na thuhet, ose lihet të nënkuptohet se investimet e huaja (perëndimore) s'po mund të depërtojnë në Kosovë si rezultat i korrupsionit dhe krimin të organizuar, ndërkohë që, përkundër autoritarizmit në rritje të establishmentit turk, shkëmbimet tregtare mes BE-së dhe Turqisë nuk është se janë në gjendjen më të keqe të mundshme, përderisa raportet politike të BE-së me Turqinë është e qartë se nuk janë në gjendjen më të mirë të mundshme.

Vlen të theksohet se në shumë qarqe të BE-së janë duke u

ngritur zëra se aktorët joevropianë janë duke u treguar shumë më të shpejtë në shtrirjen e investimeve të tyre në Ballkan sesa BE. E tash nëse një gjë e tillë është duke ndodhur e që, në fakt, është duke ndodhur, pse qytetarët e Kosovës dhe rajonit duhet të vuajnë nga ngathtësia e BE-së?! Perspektiva e rajonit mbahet gjallë me investime të mëdha në të gjitha drejtimit e mundshme, me rritje të bashkëpunimit dhe përshpejtim të procesit të integritimit evropian, përndryshe ndikimet e aktorëve joevropianë do të rriten edhe më shumë.

Pra, nëse BE-ja nuk investon mjaftueshëm në Kosovë e Ballkan, atëherë kjo zbrastëritje sigurisht se do të mbulohet nga aktorë joevropianë. E pastaj kush duhet të fajësohet? Dikush do të thoshte që BE-ja dhe shtetet anëtare të saj s'po mund të investojnë si rezultat i korrupsionit, ndërkohë që aktorët joevropianë nuk po pyesin fare për korrupsion, duke qenë vetë të zhytur thellë në të. Dilema tash është se si të dilet nga kjo situatë ku ekonomia e Kosovës dhe Ballkanit në përgjithësi nuk mund të bëjnë më shumë se ç'janë duke bërë pa masa incentive të BE-së dhe shteteve anëtare të saj dhe duke ditur që parandalimi dhe luftimi i korrupsionit merr shumë kohë.

(Vijon)



Macroni shpreh keqardhje për tërheqjen e trupave amerikane nga Siria



Paris, 23 dhjetor - Presidenti francez, Emmanuel Macron, ka thënë se i vjen thellësisht keq ndaj vendimit të fundit të homologut të tij amerikan Donald Trump për tërheqjen e trupave nga Siria. Macroni, në një konferencë për media në Çad, tha se "një aleat duhet të jetë i besueshëm".

"Më vjen thellësisht keq për vendimin e marr mbi Sirinë", shtoi ai. Më 22 dhjetor Trumpi mbrojti vendimin e tij për t'i tërhequr trupat amerikane nga Siria, pasi ai tha se ata kanë kryer misionin e tyre në mposhtjen e grupit militant, Shteti Islamik në Siri.

Më 20 dhjetor sekretari amerikan i Mbrojtjes, Jim Mattis, dha dorëheqje pas vendimit të Trumpit. Dy ditë më vonë i dërguari i ShBA-së në koalicionin global në luftën kundër IS-it, Brett McGruke, po ashtu dha dorëheqje për shkak të vendimit për tërheqjen e trupave amerikane.

A po rrezikohet marrëveshja për Maqedoninë e Veriut?

Edhe pse marrëveshja ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë për zgjidhjen e kontestit të emrit ka hyrë në fazën e fundit të zbatimit, para së gjithash në Maqedoni, reagimet e shumta në ditët e fundit në Athinë kanë ngritur dilemat nëse marrëveshja do të zbatohet nga pala greke

SHKUP, 23 DHJETOR - Marrëveshja ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë për zgjidhjen e kontestit të emrit ka hyrë në fazën e fundit të zbatimit, para së gjithash në Maqedoni, pasi vetëm pas realizimit të detyrimeve nga Shkupi zyrtar, kjo marrëveshje duhet të aprovohet edhe në Parlamentin e Greqisë. Por, reagimet e shumta në ditët e fundit në Athinë kanë ngritur dilemat nëse marrëveshja do të zbatohet nga pala greke. Partia e Greqëve të Pavarur, një nga partitë me ndikim në Qeverinë e kryeministrit grek Alexis Tsipras, është kërcënuar se nuk do ta mbështesë ratifikimin e marrëveshjes për shkak të, siç ka thënë kreu i saj, Panos Kammenos, fjalorit nxitës të kryeministrit të Maqedonisë, Zoran Zaev, se gjuha maqedonase dhe identiteti garantohej me marrëveshjen mes dy vendeve, të arritur më 17 qershor në Prespë. Madje Kammenos, që është ministër i Mbrojtjes, ka

thënë se do të largohet nga Qeveria sapo marrëveshja të jetë miratuar në tërësi nga pala maqedonase për ta pamundësuar ratifikimin e saj në Parlamentin e Greqisë. Njohësit e çështjeve politike reagimet e tilla të zyrtarëve grekë më tepër i ndërlidhin me afirmimin e zgjedhjeve në Greqi sesa me ndonjë ndryshim në politikën e tyre sa i përket zgjidhjes së 27-vjeçare të emrit me Maqedoninë. "Duhet ta dimë një fakt, se atje, si duket, ka filluar fushata parazgjedhore. Tani liderët dhe partitë politike atje ndërtojnë pozicione në bazë të disponimit të elektoratit të tyre. Fatkeqësisht, atje ekziston një bindje e cila po interpretohet si vullnet i qytetarëve kundër Marrëveshjes së Prespës", tha ai. "Kjo përqindje sikur po i ngacmon udhëheqësit e partive politike, të cilët mendojnë se do të kenë përkrahje të madhe nëse do të kenë qëndrim kundër kësaj marrëveshjeje",



thotë Ismet Ramadani, kryetar i Këshillit Euroatlantik të Maqedonisë dhe këshilltar i jashtëm i kryeministrit Zaev. Ramadani thotë se kjo marrëveshje është arritur falë angazhimit të madh të faktorit ndërkombëtar, ShBA-së, BE-së dhe NATO-s dhe ato, sipas tij, në asnjë mënyrë nuk do të lejojnë dështimin e marrëveshjes. "Është një e vërtetë që vlen edhe për këtu, se ky proces, kjo marrëveshje dhe këto procedura janë mirë të kontrolluara nga faktori relevant ndërkombëtar. Kështu që, Greqia sigurisht se do t'u përshtatet

ndikimeve që vijnë nga partnerët e saj, qoftë nga BE-ja, NATO-ja apo SHBA-ja", thekson Ramadani. Sa i përket Maqedonisë, marrëveshja ka kaluar në fazën e fundit dhe pas hartimit të amendamenteve që janë në përputhje me marrëveshjen për emrin e ri "Maqedonia e Veriut", ka mbetur edhe votimi në seancën plenare, e paraparë të mbahet më 9 janar 2019. Edhe kësaj radhe, ajo pritet të votohet me dy të tretat e nevojshme në Kuvend dhe këtë numër pritet ta sigurojnë 6 deputetët e përjashtuar nga

VMRO DPMNE-ja që fituan amnistinë për ngjarjet e dhunshme në Kuvend. Këtë formë të sigurimit të votave, analisti Alajdin Demiri, e vlerëson të turpshme dhe pafuqi të pushtetit për të garantuar proces të ndershëm. "Kjo është nonsens, është keqpërdorim i pushtetit. Është e vërtetë se kjo bëhet për qëllime sublimë, të mëdha siç i quajnë ato, por është keqpërdorim. Kjo është ajo situatë, e cila e tregon gjendjen shpirtërore dhe reale si të politikës, e cila nuk ka kapacitet që një proces ta çojë në mënyrë demokratike, por shumë lehtë hynë në situatë të kriminalitetit", vlerëson Demiri. Kontesti mes dy vendeve daton që nga viti 1991, kur Maqedonia ka shpallur pavarësinë, ndërsa Greqia ka bllokuar integrimin e saj në NATO dhe BE, me arsyetimin se fqinji i saj mund të ketë pretendime ndaj territorit të saj verior që, po ashtu, quhet Maqedoni. 27 vjet më vonë dy vendet janë pajtuar me një zgjidhje që parasheh që Maqedonia të quhet "Maqedonia e Veriut", ndërsa maqedonasit e sotëm të mos kenë lidhshmëri me maqedonasit antik, ndërsa gjuha maqedonase të pranohet se i takon grupit të gjuhëve sllave.

Erdogani dhe Netanyahu me akuza të ndërsjella



ANKARA, 23 DHJETOR - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, e ka akuzuar të dielën kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanyahu, se po kryen "terror shtetëror". "Netanyahu, ti je një tiran. Ti je në krye të terrorit të shtetëror", tha Erdogan gjatë një tubimi në Stamboll, duke e akuzuar Izraelin për "vrasjen e dhjetëra-mija njerëzve të pafa-

jshëm, grave dhe fëmijëve në Palestinë". Erdogan, një mbështetës i zëshëm i palestinezëve, ka dënuar atë që e ka përshkruar si "masakra" dhe "krime kundër njerëzimit" që, sipas tij, janë kryer nga Izraeli. Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, një ditë më parë, përmes postimeve në "Twitter", e kishte cilësuar

Erdogani "okupator të Qipros Veriore, ushtria e të cilit kryen masakra mbi gratë dhe fëmijët në fshatrat kurde, brenda dhe jashtë Turqisë". Marrëdhëniet në mes të Turqisë dhe Izraelit janë të tensionuara për shkak të një varg çështjesh, përfshirë edhe një ligj të miratuar këtë vit nga Izraeli, ku ky shtet konsiderohet si atdheu i popullit hebre.

Qindra të vdekur e të plagosur nga cunami në Indonezi

XHAKARTA, 23 DHJETOR - Një cunami goditi plazhet e Sunda Straits në Indonezi dhe, sipas agjencisë së emergjencave, numri i të vdekurve ka arritur mbi 200, ndërsa 745 veta janë plagosur.

Purwo Nugroho, zëdhënës Agjencisë Kombëtare për Zbutjen e Katastrofave, tha se qindra shtëpi, nëntë hotele dhe 10 anije janë dëmtuar nga cunami që goditi në tre rajone të Indonezisë.

Agjencia për Meteorologji, Klimë dhe Gjeofizikë (BMKG) raportoi për një shpërthim të vullkanit në Krakatoa, rreth orës 9.00 të mbrëmjes së të shtunës sipas kohës lokale, dhe cunami goditi rreth gjys-

më ore më pas. Sipas agjencisë, cunami mund të ishte rezultat i një kombinimi të rrëshqitjeve të dheut pas shpërthimit të malit Anak Krakatoa dhe baticës së shkaktuar nga hëna e plotë.





BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



E jashtëzakonshme

Muzikanti i binte kitarës derisa operohej në tru

Një muzikant në Afrikën e Jugut i ka lënë pa fjalë disa mjekë që po kryenin një operacion në trurin e tij. Kitaristi Musa Manzini ka marrë kitarën pas gjashtë orëve operacion dhe ka luajtur muzikë. 47-vjeçari Musa kishte tumor në tru që nga viti 2006, por asnjëherë nuk kishte hyrë në



operacion. Gjatë operacionit që zgjati gjashtë orë, ai ishte zgjuar. Manzini ka bërë me dije se do t'i rikthehet sërish muzikës sapo të rikuperohet.

BARSOLETA E DITËS



Pacienti: Doktor, më dhembin shumë shpatullat.
Doktori: Ju keni nevojë për më shumë diell.
Pacienti: Doktor, jeni i sigurt?
Doktori: Duhet të më besoni, se që 30 vjet jam mjek.
Pacienti: Edhe unë që 30 vjet jam roje plazhi.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

FOTO E DITES



Një viktimë e dhunës seksuale e mbuluar me shami merr pjesë në një marsh në Mumbai të Indisë. /AP/

E rrallë


Burri dorëzon çantën me para në polici

Një burrë amerikan ka dërguar në polici një çantë me 10 mijë dollarë brenda, që e gjeti në një platformë metroje. Syri i Richard Taverna kapi shpejt çantën "blu Chanel" në platformën e trenit në Lincoln Center javën e kaluar. Brenda çantës kishte një shënim në rusisht. Pasi nuk gjeti agjent policie në stacion, burri e çoi atë në stacionin policor. Policia konfirmoi se qesja i përkiste një gruaje që jeton në Manhattan.



 <p>DASHI Jeni të hapur dhe të sinqertë me të gjithë sot dhe kjo është një veçori e juaja. Një udhëtim pune do t'i prishë planet e ditës.</p>	 <p>DEMI Edhe pse sot mendoni për punën dhe karrierën, do të vëreni se nuk mund t'i anashkaloni çështjet e zemrës dhe partnerin.</p>	 <p>BINJAKËT Sot po përpiqen t'ju vënë shkopinj nën rrota. Kjo gjë nuk do t'ju pengojë aspak të arrini ato synime që i keni vënë vetes.</p>	 <p>GAFORRJA Po e ndieni që pushimet po afrojnë dhe kjo gjë po ju pëlqen. Një gotë vere në mbrëmje do të kalojë në biseda shumë të ngrohta me partnerin.</p>	 <p>LUANI Dita do të nisë pak e zymtë sot për shkak të një takimi që nuk do të shkojë dhe aq mirë. Pasditja do të jetë e përkryer.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Sjellja juaj e mbyllur, pesimiste dhe superkritike sot, do të krijojë probleme të mëdha në komunikim.</p>
 <p>PESHORJA Edhe pse po dëgjoni shumë fjalë vërdallë, përsëri kjo gjë nuk do ta prishë harmoninë në çift. Një ditë e bukur dhe e qetë sot për ju.</p>	 <p>AKREPI Nuk keni dhënë shumë nga vetja në një çështje që është më e rëndësishme sesa që mendoni. Do të prisni që gjërat të qetësohen, por do të jetë vonë.</p>	 <p>SHIGJETARI Sapo keni dalë nga një lidhje e rëndësishme për ju dhe kjo gjë ju ka tronditur disi. Për ata që presin rritje në karrierë, nuk ka ardhur çasti.</p>	 <p>BRICJAPI Jeni duke menduar se si do ta kaloni ditën dhe e keni gjetur zgjidhjen. Në shoqërinë e miqve do të kaloni çaste shumë të këndshme.</p>	 <p>UJORI Paraqitet një ditë shumë e nxehtë për këtë shenjë. Flirte të reja në horizont dhe pasion në rritje. Dikush pret një përgjigje nga ju.</p>	 <p>PESHQIT Pakënaqësitë që keni krijuar me njerëzit që ju rrethojnë ditën e sotme sa do të vijnë e do të shtohen. Do të keni një përballje të sikletshme.</p>

Rihanna do t'i kthehet muzikës me një album



Këngëtarja e njohur Rihanna tash e sa kohë nuk ka qenë aktive në muzikë, pas angazhimit të saj si stiliste në markën personale "Fenty" dhe në rolin e saj si aktore në "Oceans 8". Fansat, siç duket, nuk ishin të kënaqur nga ky mosaktivizim i këngëtares në fushën

e muzikës dhe në llogarinë e saj mijëra pyetje ishin adresuar për datën e këngës së saj më të re. Dhe Rihanna kishte vendosur t'u përgjigjej duke i befasuar të gjithë, pasi ajo nuk po rikthehet vetëm me një këngë, por me një album që pritet të publikohet në vitin 2019.

Familja Bieberit me një anëtarë më shumë



Cifti i njohur Justin dhe Hailey Bieber, të cilët lidhen kurorë në muajin nëntor, kanë vendosur ta rrisin familjen e tyre dyanëtarëshe. Ata të shtunën që lamë pas prezantuan në rrjetet sociale qenin e tyre të quajtur "Oscar". Justini poshtë fotos kishte shkruar "njihuni me djalin tonë qenush", kurse në anën tjetër Hailey e kishte vlerësuar si një dhuratë për Krishtlindje.




Kylie Jenneri si një 'engjëll' në Los Angeles

Në botën e shoubizit është një traditë që sapo të kesh paraqitje publike duhet të dukesh tejet bukur. Kështu në Los Angeles u paraqit edhe Kylie Jenner, e veshur në një fustan të bardhë. Jenneri

dukej shumë bukur edhe pse tashmë nuk ka vetëm obligim ndaj vetes, por edhe ndaj vajzës së saj Stormi. Mund të themi se pamja e saj është një mënyrë se si të vishemi për festat e fundvitit.

Ndahet çifti i njohur



Dylan O'Brien dhe Britt Robertson janë ndarë pas gjashtë vjetësh në lidhje. Çifti thuhet se i ndau rrugët pak muaj më parë. Fansat kanë nisur të spekulojnë se

Britti tani është në lidhje me Graham Rogersin, pasi të dy u panë bashkë kohët e fundit. Dylani dhe Britti kanë nisur lidhjen pasi u takuan në setin e filmit "The First Time" gjatë vitit 2012.



Autor: GAZMEND MORINA	PËRMASË	SHËNIME QË MBAHEN NË NJË FLETË LETRE A NË NJË REGJIS-TËR (shq.)	VARRI I NJË SHENJTORI MYSLIMAN	INDIUM, ELEKTRON	POLITIKANI YNË PASKAL	UGANDA, TANZANIA	SHTET NË EVROPE (pashq.)	EPOKA E RE	BASHKËT.	NJË PLANET	KOLOS
AKTORJA AMERIKANE NË FOTO (shqip.)								NJË LLOJ BUFI QË KA TË BËJË ME FSHATIN, FSHATARESKE			
QË KA HUMBUR NJOMËSINË, I FISHKUR									"RIZONI" KALORËS MESJETAR (shq.)		
SHKRIMTARI YNË GOJANI						EMËR YNI MASHKULLI POLITIKANI SUEDEZ ... BILDT					
KËNGËTARJA ... ZARI				VEGËL MUZIKORE ZANORE							
					RROGË VJETORE E PAPËS BIMË BARISHTORE NJËVJEÇARE					NAPOLI ALEANCE	
PAGJAKËSI SULFUR, NIKEL				QYTET NË MAQEDONI SHTAGA							LETRA
IMER CANA			PYLL PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT				ZOG I EGËR GRABITQAR ISH FUTBOLLISTI HOLANDEZ KLAIVERT				
EPOKA E RE	LËNG I TRASHË QË NXIRRET NGA KULLIMI I NAFTAËS	GAZ QË PËRDORET PËR TË PASTRUAR MIRË PLAGËT (shq.)	ELEMENT KIMIK (NT)	OLIVER (shk.)	GAZETË QË BOTOHET NË SHQIPËRI	GJELBËRIM NË SHKRETË-TIRË (sh.shq.) ONTARIO, TENESI			BASHKËT. FIJE E HOLLË PAMBUKU		SHKOVA, ECA QË LIDHET ME TEORINË
QË S'KA LARMI; I MËRZITSHËM						FAZAT AKTORJA ME FAMË BOTËRORE THURMAN				DY BASHKË-TINGËLLORE TOTENHAM	
SHTËPI PLEQSH (sh.shq.)					BASHKIM I FORTË (sh.shq.) EMËR I VJETËR PËR LUBJANËN						TREVISO TEKSTI QË SHËRBEU SI BAZË PËR NJË FILM
PREMTIM QË JEPET PËR TË BËRË DIÇKA NË NJË KOHË TË CAKTUAR					AKTORJA DHE KËNGËTARJA ... TOSKA AKTORJA AMERIKANE RODRIGUEZ			"RODA" QYTET I MADH NË SHBA		"SAN ANTONIO" SMALT	
NJË (IT.)			USHTRIA AKTORI I FAMSHËM ANGLEZ BLOOM					TRA I ÇATISË ZËRI I FORTË QË NXJERR NJËRIU KUR BËRTËT			LLOJ KOSI ME HUDHRA
FUTBOLLISTI ARGJENTINAS ... COSTA					AMERICA ONLINE DY ZANORE	IPSVICH PËRPEKJA PËR TA VRARË NJË POLITIKAN		URATAT AUCKLAND HOME EDUCATORS			
EPOKA E RE	ZEJTAR (shq.)	DEPARTMENT OF REVENUE	PORTIERI SPANJOLL PEPE ... REGJISORI ... HALILI			TË BUKURIT MA JEP			QYTETI FRANCEZ I FILMIT ILLINOIS VIRTUAL SCHOOL		
KËNGËTARE E JONA E NJOHUR										DAFINË SHTËT NË AZI	
KRYEQYTETI I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN					ZANORE ANTALYA	E TRAN-SMETOVA, E ... MJET LUFTE					RAMADAN AVDIU DY ZANORE
DERA E VOGËL E THURUR ME THUPRA					KËNGËTARJA ... OKSA AKTOR KOMEDISH			BIMË NJËVJEÇARE ME KËRCËLL TË FORTË (shq.) ZILIA, INATI			TROYES DAULLE
INTER		NAMIK DOKLE MËNYRË E VEÇANTË E TË VESHURIT			KENNEDY ROAD TABERNACLE METALI I HOLLUAR			KRAHINË NË SHQIPËRI KUMBARA		SLOGAN BASHKËT.	
DY BASHKË-TINGËLLORE			OSMANËT AUDIO VIDEO INTERLEAVE						BETIM (bised.) DIPLOMATI NORVEGJEZ ... EDIE		"URUGUAI" KATËR (romak)
FILM I YNI "... ISHIN KATËR"				QË I ËSHTË PËRCAKTUAR MADHËSIA (F) EMMY ROSSUM				BASHKËT. DY BASHKË-TINGËLLORE		DJALË I VËLLAIT A I MOTRËS LLOJ REVOLEJE	TEFTA TASHKO
LARTËSIA QË ARRIN NJË SIPËRFAQE UJI E LIRË					NISMAT ZANORE						
QË KA TË BËJË ME PARAARDH-ESET TONA						I AFROVA (bised.)				NITON	

Në 50-vjetorin e demonstratave të vitit 1968 në Tetovë (2)

Mehmetriza Murtezani - Mehmet Gega, Demaçi i Tetovës



Lulëzim ETEMAJ

Me luftë të armatosur kanë dashur që Tetovën, Gostivarin, Dibërën, Kërçovën dhe Strugën t'i bashkojnë një herë me Kosovën e pastaj me Shqipërinë. Udhëheqësi shpirtëror i këtij grupi ka qenë Mehmetriza Murtezani, nacionalist shqiptar i përbetuar... të gjithë kanë qenë organizatorë të demonstratave nacionaliste në Tetovë më 22 dhe 23 dhjetor të vitit të kaluar, kur duke tërhequr me vete grupin e anëtarëve të kombësisë shqiptare kanë shqiptuar me zë të lartë parulla armiqësore dhe seperatiste, thuhet ndër të tjera në raportin me titull "14 organizatorë të demonstratave të Tetovës së shpejti para gjyqit", mbi aktakuzën e prokurorit publik të qarkut të Shkupit, Vanço Proevski, të dorëzuar gjyqit, ku figurojnë emrat e 14 shqiptarëve nga Tetova dhe Gjakova, të arrestuar duke filluar nga data 24 dhjetor 1968: Mehmetriza Murtezani - Gega (48 vjeçar), mekanik i fabrikës së tekstit "Teteks" në Tetovë, Faik Mustafa (24), mësues, Abdylselam Selami (30), mësues, Ramadan Sinani-Ramushi (25), mësuesdhënës i gjimnazit të Tetovës, Fehmi Rufati (22), student i fakultetit të filozofisë në Shkup, Xhemajl Mustafaj (23), student, Agim Xhaferi (23), student i fakultetit të drejtësisë në Shkup, Arbën Xhaferi (21) student i fakultetit të filozofisë në Beograd, Abdulmenaf Xhaferi (23), mësues, Usmixhevat Useini (24), punëtor i painkuadruar, Isniqemal Sherifi (26), murator, Refik Murati (34), mësues që të gjithë nga Tetova, si edhe Agim Jaka (21) nga Gjakova, student Fakultetit të filozofisë në Prishtinë, dhe Ibrahim Rudi (23) nga Gjakova, student i Fakultetit të filozofisë në Prishtinë.

Afër dy vite para burgosjes nën akuzën për organizimin e demonstratave të 22 dhe 23 dhjetorit 1968 në Tetovë, më 27 nëntor 1967, tetë pjesëtarët e këtij grupi mblidhen në shtëpinë e Mehmet Gegës, në Tetovë, për të festuar së bashku Ditën e Flamurit, Mehmet Gega, Faik Mustafa, Ramadan

Sinani, Hysenxhevat Kalishta, Mihtar Zymberi, Fehmi Rufati, Abdylselam Selami, Xhemajl Mustafaj, Arbër Xhaferi dhe Abylmenaf Xhaferi. Festimi i Ditës së Flamurit, ashtu si dhe përdorimi i flamurit kombëtar, për shqiptarët e mbetur nën ish- Jugosllavi në këtë kohë ende ishte e ndaluar dhe sanksionohet me dënimin me burg. Një muaj para demonstratave në Tetovë, në shumë qytete të Kosovës kishin shpërthyer demonstrata të fuqishme të rinisë studentore, ku krahas statusit të republikës për Kosovën, ishte kërkuar edhe hapja e Universitetit të Prishtinës, bashkimi i viseve tjera shqiptare të Kosovës dhe vetëvendosja deri në shkëputje. Duke qenë në vitin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, 90-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 60-vjetorit të Kongresit të Manastirit, Kongresit të Gjuhës Shqipe, tek shqiptarët shfaqet në këtë kohë një zgjim i veçantë i ndjenjës së krenarisë kombëtare, duke i dhënë kështu përmasa të reja, më përfshirëse, në kuptimin gjeopolitik, Lëvizjes Politike Çlirimtare për të drejta të plota kombëtare, përfshirë edhe të drejtën për vetëvendosje, si parakusht i bashkimit kombëtar dhe bërjes së Shqipërisë, siç shprehet Mehmet Gega, duke e njohur në thelb të vërtetën historike dhe shkencore se një Shqipëri e tillë, e copëtuar, nuk mund të konsiderohet në asnjë rrethanë Shqipëri e bërë.

Aktakuza e Prokurorit të Gjykatës së Qarkut në Shkup kundër Mehmet Gegës dhe të gjithë grupit në fakt përveç terminologjisë sforceuse në shërbim të përpjekjes për diskreditimin e tyre politik, është e qëndrueshme. Është e qëndrueshme për faktin se Mehmet Gega edhe pas lirimit në vitin 1962 nga vuajtja e dënimit të parë, jo vetëm që nuk kishte shfaqur shenja frikësimi apo thyerjeje gjatë vuajtjes së dënimit të rëndë, por me të gjithë qenien e tij njerëzore kishte vazhduar luftën kundër padrejtësive dhe shtypjes që po u bëhej shqiptarëve nga pushteti maqedonas, përkatësisht në krijimin e parakushteve të domosdoshme që do të shpinin në jetësimin e synimit që irredentizma shqiptare, e përfaqësuar nga prijësi Adem Demaçi në Prishtinë dhe tani edhe nga Mehmet Gega në Tetovë, i kishte vënë vetes: bashkimin me shtetin amë- Shqipërinë dhe bërjen e

Shqipërisë. Ky qëndrim, guximi, zgjuarsia dhe afria me të rinjtë e bëri atë të veçantë, të dashur, të respektueshëm dhe e shndërroi në simbol të vërtetë frymëzimi për ta në angazhimet politike kombëtare, përfshirë edhe ato luftarake gjatë luftës çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si dhe të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, për ç'gjë edhe filluan në shenjë admirimi ta thërrisnin Baca Mehmet, njëjtë siç po veprimeve tashmë prej sa kohësh edhe me Adem Demaçin.

Në këtë kuadër, dënimi prej 7 vitesh burgim të rëndë, që Gjyqi i Qarkut në Shkup më datën 25 prill 1969 i shqipton Mehmet Gegës nuk paraqet asnjë befasi, por është një rrjedhojë logjike, e pritshme, për çdo atdhetar që mbi çdo gjë, mbi çdo rrezik, vuajtje dhe sakrificë të tijen, ka vënë fatin e popullit të tij, përkatësisht qëndresën e paepur dhe luftën e vazhdueshme për të drejta të ligjshme njerëzore, politike dhe kombëtare.

Të gjithë dënimin prej 7 vitesh, Mehmet Gega e vuajti në burgun famëkeq të Idrizovës, ku e gëzoi po ashtu nderimin dhe respektin merituar nga bashkëvuajtësit shqiptarë për afërsinë, kujdesin dhe urtinë e treguar ndaj tyre si dhe qëndresën dhe guximin e manifestuar përballë zyrtarëve të burgut, shovenistë madeqonase dhe serbë.

Duke i mbetur besnik deri në

skaj idealit të tij - bashkimit kombëtar, Mehmetriza Murtezani-Gega, pas daljes nga burgu nuk pranoi kurrë të bëhej pjesë e kornizave gjeopolitike të programeve të partive politike të shqiptarëve nën Maqedoni, por vazhdoi të përçoi në çdo hap mesazhin e përbashkimit rreth të njëjtë flamur, atij shqiptar, dhe shtet, Shqipërisë së bashkuar, duke e vënë kombin mbi çdo gjë, dhe në këtë aspekt, edhe përkundër faktit se ishte fetar, kultivonte frymën rilindase dhe ishte i pakompromis në luftë me të gjithë ata hoxhallarë dhe besimtarë që përparësi i jepnin fesë dhe e nënçmonin kombin, duke i paraqitur shqiptarët si myslimanë të Maqedonisë në vend se si shqiptarë të fesë islame siç janë shqiptarët tjerë, shqiptarë të fesë së krishter, gjë që shkon në favor të sllavëve dhe të gjithë armiqve të popullit shqiptar.

Një kapitull i veçantë, krejt i natyrshëm, i jetës dhe veprimtarisë politike kombëtare të Mehmet Gegës, paraqet edhe përkrahja e fuqishme që ai i jep pajtimin të gjaqeve në vitin 1990-1991 në Kosovë, të filluar më 2 shkurt 1990 nga rinia e Pejës, dhe rinisë bartëse të këtij pajtimi, të Tetovës dhe Gostivarit, të cilët që në fillim, duke u drejtuar tek ai, u drejtuan në adresën e saktë dhe e gjetën gjithë mbështetjen e nevojshme të ofruar prej tij. Nga ajo kohë, viti 1990, personalisht nuk do ta harrojë kurrë

pamjen e tij prej një njeriu të urtë, të dashur, tejet të sjellshëm, jo imponues, vital në shfaqjen e mendimit dhe argumentimit të pikëpamjeve. Kapitull i veçantë i jetës së pasburgut të dytë të Mehmet Geges, është afria dhe miqësia e tij, edhe familjare, me Adem Demaçin, si dhe takimet dhe ndejat e shpeshta të realizuara gjatë atyre viteve si në Prishtinë ashtu dhe në Tetovë si dhe respekti që tregonte ndaj tij Adem Demaçi, për të cilin Mehmet Gega ishte hero i vërtetë i kombit tonë, pavarësisht fatit që ai vdiq në krevat dhe jo në beteja të ndryshme apo në kthetrat e armiqve nëpër burgje.

Adem Demaçi dhe Mehmet Gega janë dy nga prijësit shpirtëror të irredentizmit shqiptar, me rrënjë në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 10 qershor 1878, pa të cilët liria e Kosovës, vetë shteti i Kosovës, si zgjidhje dhe hap shumë përparësive të jetësimit të idealit të tyre, mbase do të mund të ishte edhe sot e kësaj dite një synim ende i pa jetësuar nga gjenerata e tanishme.

Duke u nisur nga ky fakt si dhe duke marrë për bazë edhe dënimet e rënda që i janë shqiptuar, dy herë nga 10 vite, prej të cilave 14 vite i ka kaluar nëpër burgje, Mehmet Gega, anipse në moshë më të shtyer se sa Adem Demaçi, cilësohet më të drejtë edhe si Demaçi i Tetovës.

(Fusnotat i ka hequr redaksia. Fund)



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ANTALYASPOR - FENERBAHCE

3+

AKHISAR BELEDIYESPOR - KONYASPOR

3+

ALTINORDU - GIRE SUNSPOR

1

Konfirmohet miqësorja ndaj Danimarkës

Kosova në futboll më 21 ose 22 mars do të zhvillojë ndeshje miqësore me Danimarkën para ndeshjes së parë kualifikuese që e zhvillon më 25 mars ndaj Bullgarisë. "E kemi obligative zhvillimin e dy ndeshjeve miqësore, pasi jemi në grup ku bëjnë pjesë pesë skuadra për kualifikimet e Kampionatit Evropian. Mund të them se miqësorja me Danimarkën thuajse është e përfunduar", ka thënë Agim Ademi, kryetar i FFK-së

**EPOKA E RE****Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll, pas suksesit historik në Ligën e Kombeve ku është kualifikuar në "play-off" të kësaj gare, pritet të zhvillojë ndeshje miqësore ndaj Kombëtares së Danimarkës. Lajmin e ka konfirmuar të dielën për "Epokën e re" kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi. "E kemi obligues zhvillimin e dy ndeshjeve miqësore, pasi jemi në grup ku bëjnë pjesë pesë skuadra për kualifikimet e Kampionatit Evropian. Mund të them se miqësorja me Danimarkën thuajse është e përfunduar", ka thënë

Ademi, i cili konfirmoi se kjo ndeshje zhvillohet në muajin mars në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. "Kjo ndeshje do të zhvillohet para fillimit të ndeshjeve kualifikuese, pra para ndeshjes me Bullgarinë në muajin mars. Ndeshjen e parë në kualifikime e zhvillojmë në Prishtinë dhe normalisht se edhe ndeshjen miqësore e zhvillojmë si vendës", ka shtuar ai.

Pas rezultateve të mira në Ligën e Kombeve dhe ngritjes për 46 pozita në renditjen e FIFA-s për vitin 2018 dhe renditjes në vendin e 131-të, "Dardanët" kanë pasur shumë ftesa për zhvillimin e ndeshjeve miqësore, përfshirë edhe kombëtare të mëdha si Uells, ku luan ylli i Real Madridit, Garath Bale. "Ne kemi pasur shumë

oferta për të zhvilluar miqësore nga Uells, Gjibraltari dhe Lihtenshtajni, por edhe nga kombëtare të tjera të respektuara. Ka qenë një gjë shumë pozitive, por edhe e papritur që shumë skuadra të njohura ta kërkojnë zhvillimin e ndeshjeve miqësore me Kosovën. Normalisht se ne jemi krenarë për faktin se këto oferta kanë ardhur pas paraqitjeve tona të mira ku në pesëmbëdhjetë muajt e fundit nuk kemi pësuar asnjë humbje dhe kemi pranuar dy gola", ka deklaruar Ademi.

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll, e cila drejtohet nga Bernard Challandes, është në Grupin A në kualifikimet për "Euro 2020" së bashku me Anglinë, Bullgarinë, Çekinë dhe Malin e Zi.

SHKURT

Greza, titullar në fitoren e Rangersit. Muriqi asiston në humbjen e Rizesportit

Rangersi arriti një fitore tepër të rëndësishme në transfertë përballë St. Johnstone me rezultatin 1-2. Eros Greza ishte pjesë e formacionit titullar, ndërsa Stiven Gerrardi e la në stol gjatë pushimit mes pjesëve. Trabzonspori e shkatërroi Rizesporin e Samir Ujkanit dhe Vedat Muriqit me rezultatin 4-1 dhuroi asistimin e golit për skuadrën e tij.

Areola vazhdon kontratën me PSG-në

Alphonse Areola ka zgjatur kontratën me Paris Saint-Germain deri në vitin 2023. Shoqëria parisienne me rinovimin e marrëveshjes me portierin u jep fund zërave për një largim të mundshëm të tij nga "Parc des Princes".

"Alphonse është një nga simbolet kryesore të skuadrës sonë. Kryesia e klubit dhe tifozët tanë e vlerësojnë shumë besnikërinë që ka shfaqur ndaj shoqërisë kur zgjodhi të nënshkruante me afat të gjatë", ka deklaruar presidenti Naser Al-Khelaifi.

Shqiptari shpallet kampion bote në kikkoks

Kikkoksieri shqiptar Adriatik Cami është kampion bote në kategoritë WKF dhe WIPU. Kampioni nga Dibra hodhi në knock-out kundërshtarin nga Maroku që në raundin e dytë, duke bërë të vetët rripin e dy titujve. Në sallën sportive "Feti Borova" takimi nisi në malore për Camin që iu imponua grushteve dhe dominimit të kundërshtarit, por i ruajti forcat për t'i gjetur goditjet fatale në raundin e dytë. Disa goditje të sinkronizuara të Camit e detyruan kundërshtarin 22-vjeçar të dorëzohet, duke i dhënë të drejtë shqiptarit për të vendosur në brez dy titujt.

Rashfordi, objektiv i Barçës

Barcelona është e interesuar për transferimin e sulmuesit të Manchester Unitedit, Marcus Rashford. Lajmi është bërë me dije nga mediumi britanik "Sunday Express", drejtuesit e Barçës e kanë etiketuar sulmuesin anglez për të ardhmen, pasi e ardhmja e tij afatgjatë në "Old Trafford" është në dyshim. Anglezi mund të kërkojë të largohet nga Unitedit nëse nuk do të bëhet një titullar fiks i trajnerit të ri Ole Gunnar Solskjaer. Interesim për sulmuesin anglez ka shfaqur edhe skuadra e Milanit.

Llapi, afër marrëveshjes me Shilloven

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Skuadra e Llapit është shumë afër arritjes së marrëveshjes me sulmuesin e Flamurtarit, Alban Shillova. Gazeta

"Epoka e re" ka mësuar se bisedimet janë duke u zhvilluar që disa ditë dhe kalimi i sulmuesit më të mirë për sezonin vjeshtor në skuadrën

nga Podujeva pritet të bëhet gjatë këtij viti. Siç dihet, Llapi ka bërë sërish ndryshime në shtabin teknik, ku në vend të Bekim Shotanit, e ka

angazhuar trajnerin nga Maqedonia, Xhengis Rexhepi, i cili është trajner i licencuar me 'UEFA A Pro Licence', kurse më herët ka qenë ndih-

mëstrajner te skuadra e Sivassporit në Turqi, ndërsa mban postin ndihmëstrajnerit edhe në Përfaqësueses së Maqedonisë.

Feronikeli, "mbret" i Ligës së Parë në basketboll

DRENAS, 23 DHJETOR - Skuadra debutuese në Ligën e Parë të Kosovës, Feronikeli, ka dominuar në këtë ligë në stinorin vjeshtor. Në 9 xhiro të luajtura basketbolistët e Feronikelit nuk dinë për humbje dhe kështu kanë grumbulluar maksimumin e pikëve, gjithsej 18 sosh. Menjëherë pas

Feronikelit renditet Vëllaznimi që e ka të regjistruar një humbje nga Feronikeli dhe kjo është arsyeja që skuadra nga Gjakova ka tubuar 17 pikë dhe renditet e dyta. Në pozitën e tretë ndodhet Istogu me bilanc prej 6 fitoresh e 3 humbesh me 15 pikë, aq sa ka edhe Don Bosko nga Prishtina

dhe që është në pozitën e katërt. Më pas renditet Drita si e pesta me 5 fitore e 5 humbje me 14 pikë, kurse Prishtina e Re ka bilanc prej 4 fitoresh e 5 humbesh me 12 pikë në vendin e gjashtë. Penza është në pozitën e tetë me 3 fitore e 6 humbje me 12 pikë, kurse Vushtrria dhe Kerasan


Prishtina kanë regjistruar nga 2 fitore e 7 humbje dhe kanë nga 11 pikë. Vushtrria është në vendin e tetë, kurse Kerasan Prishtina në të 9-tën. United Basket nga Gjilani nuk ka arritur të shijojë asnjë fitore në nëntë xhiro, prandaj edhe renditet në vendin e nëntë me 9 pikë.



Vetteli: Në 2019-n synoj titullin e kampionit

ROMË, 23 DHJETOR - Piloti i Ferrarit, Sebastian Vettel, ka publikuar një letër drejtuar skuadrës së tij. Ai e ka bërë të qartë objektivin për vitin 2019 që është, pa dyshim, fitorja e kampionatit të Formulës 1. "Ju falënderoj të gjithëve për gjithçka. Edhe pse nuk arritëm dot ta sjellim titullin botëror në Maranello, mund ta themi me zë të lartë që dhamë maksimumin, e duhet të vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duhet t'i përveshim mëngët, të përpiqemi të komunikojmë më mirë mes nesh, me besim e vlerësim reciprok. Ta ndihmojmë njëri-tjetrin për gjithçka. Vetëm duke punuar si një skuadër e fortë dhe e bashkuar mund ta bëjmë hapin tjetër", shkruan Vetteli në letrën e tij.

Në letrën e tij, Vetteli bëri edhe një premtim personal, që ka të



bëjë pikërisht me objektivin e "kokëkuqes" italiane. "Ju pretoj se për vitin 2019 do të jap gjithçka që mundem për ta arritur objektivin tonë madhor", vijon letra e Vettelit. "Ju uroj të gjithëve më të mirat e fale-minderit shumë, Sebastian!" Pas

një faze të parë shumë të mirë të sezonit 2018 në Formulën 1, Sebastian Vetteli humbi shumë terren kundrejt rivalit Lewis Hamilton në pjesën e dytë të tij, e në fund u mposht sërish nga britaniku, që siguroi titullin e pestë për pilotë në karrierë.

Houstoni triumfon në sfidën ndaj San Antonios

HOUSTONI, 23 DHJETOR - Houstoni mposhti 108-101 San Antonion, ndeshje mes dy ekipesh që kanë zhgënjyer këtë sezon në NBA, duke qëndruar ende në vendet e fundit në Konferencën e Perëndimit. Sfidë ku të dyja ekipet dueluan deri në fund për fitoren, ku herë udhëhiqte njëra skuadër e herë tjetra. Një ndeshje fantastike e Hardenit, autor i 39 pikëve e 10 asistimeve, mbështetur edhe nga kapela me 21 pikë e 23 rebounde, një dyshe që bëri diferencën në fushë. Për San Antonion u dallua DeRozan me 28 pikë, por që mbetën për statistikë. Fiton edhe skuadra kampione e Golden States, që mundi me vështirësi 120-116 Dallasin, një përballje me emocione dhe



rivalitet deri në fund. Warriors triumfoi vetëm në periodën e fundit falë 29 pikëve e 12 reboundeve të Durant, por mirë u paraqitën edhe Jerebko me 23 pikë e Curry me 22. Te Dallas 7 lojtarë realizuan mbi 10 pikë, por kjo nuk mjaftoi për të fituar. Në sekondat e fundit triumfoi edhe Oklahoma, që mundi 107-106 Utah Jazzin jashtë fushë. Një ndeshje magjike e Paul Georges, që realizoi 43 pikë e 14 rebounde, lider në fushë për Thunderin. Një

ndeshje maratonë ajo mes Washingtonit e Phoenixit, fituar nga vendësit 149-146, takim që u vendos pas tri kohëve shtesë. Beali realizoi 40 pikë, 11 rebounde e 15 asistime, mbështetur edhe nga Bryanti me 31 pikë e 13 rebounde. Pa probleme fiton skuadra e Clippersit, që mposhti 132-111 Denverin, një duel mes dy ekipesh pretendente në Perëndim. Harrisi e Gallinari realizuan nga 21 pikë secili në fitoren e ekipit kalifornian.

REZULTATET

Clippers - Denver	132-111
Washington - Phoenix	149-146
Philadelphia - Toronto	126-101
Houston - San Antonio	108-101
Miami - Milwaukee	94-87
Golden State - Dallas	120-116
Utah Jazz - Oklahoma	106-107

SHKURT

Mësohet e ardhmja e Ansi Nikës

Ansi Nika u largua këtë verë nga Laçi pas një sezoni e gjysmë me fanellën bardhezi. Më parë anësori i krahut të djathtë ka qenë pjesë e Vllaznisë, Teutës, Kukësit dhe Tiranës. Në fillim të sezonit pati një ofertë nga Gjilani dhe e pranoi atë. Pjesën e parë të sezonit shkodrani ka qenë një nga më të spikaturit dhe është një nga lojtarët më të dashur të tifozëve. Së fundmi ka pasur lajme për një largim të tij nga Gjilani, që është mohuar nga klubi dhe nga vetë Nika. "Me anë të kësaj shkrese mohojmë informacionet e fundit të dala nga mediet online, për largimin e futbollistit tonë Ansi Nika. Futbollisti në fjalë ka kontratë me klubin deri në qershor të vitit të ardhshëm dhe ai do të jetë pjesë e skuadrës të paktën deri në këtë afat kohor. Gjithashtu, klubi njofton se, përveç lojtarëve të larguar ditët e fundit, pjesa tjetër e ekipit momentalisht mbetet e paprekur", shkruan klubi i Gjilanit. Në të njëjtën linjë është edhe Nika, që në llogarinë e vet në "Facebook" shkruan: "Për të gjithë 'Skifterat', jam pjesë e Gjilanit dhe do të jem të paktën deri në përfundim të kontratës. Respekt për 'Skifterat', jeni të mrekullueshëm. Forca, Gjilan!"

Barça, ofertë të 'çmendur' për Mbappen

Barcelona duket se ka në letër planin më të madh në histori të transferimeve. Ata janë të gatshëm ta ofrojnë yllin e skuadrës, Philippe Coutinho, si dhe 150 milionë euro për shërbimet e Kylian Mbappe, shkruan "Don Balon". Drejtuesit katalunas mendojnë se kjo do të ishte e mjaftueshme për drejtuesit e PSG që ta lirojnë yllin e tyre. "Blaugranët" janë admirues të të riut francez, i cili është edhe fitues i Kupës së Botës, por është e ditur se PSG-ja nuk do ta lirojë atë për shkak të financave, kështu që ata kanë ofruar edhe kualitet anash të hollave. Coutinho është mik i mirë me Neymarin, gjë që më vonë do të mund ta bindte brazilianin për ta vazhduar rrugëtimin në Ligën 1.

Bayerni 'blindon' Hummelsin

Mbrojtësi Mats Hummels nuk do të largohet nga Bayern Muncheni. Lajmin e ka konfirmuar drejtori sportiv i klubit 'bavarez', Hasan Salihamidzic, i cili deklaroi: "Ai do të qëndrojë, absolutisht". Bayerni është duke përcjell edhe mbrojtësin e Atletico Madridit, Lucas Hernandez dhe sulmuesin e Leipzigut, Timo Werner.

Nëna e Astorit: Nuk dua një fajtor, ja çfarë ndjeva atë mëngjes

Ndarja nga jeta e Davide Astorit ka prekur gjithë botën futbolistike në Itali dhe më gjerë. Kapiteni i Fiorentinës ndërroi jetë për shkak të një sulmi që e preku atë në gjumë. Për "Corriere della Sera", nëna e Astorit ka rrëfyer atë çka ka përjetuar kur ka marrë lajmin. "Jam nënë dhe kam edhe dy fëmijë të tjerë. Jam e detyruar të jem e fortë jo për vete, por për ata. Atë mëngjes së bashku me burrin tim do të shkonim për të votuar, por kur u zgjova ndjeva që krahët e mi ishin paralizuar, të ftohtë dhe ndiheshja e zbrazët. Nuk e kisha provuar kurrë më parë këtë në jetë. Nuk dua një fajtor, por dua vetëm arsyen. E din që fajtori nuk ekziston. Ajo çka ndodhi ishte fatkeqësi dhe jam e bindur se askush nuk e donte. Dua që kjo mos të përsëritet më. Jam e bindur se në Itali janë të mirë të gjithë mjekët e kontrolleve, por duhet të jenë edhe më të mirë", u shpreh nëna e tij.

Roma e kërkon Batshuayin

Me Patrik Schick, i cili nuk po arrin ta gjejë golin, Roma është e detyruar të hidhet në treg për të siguruar një sulmues për pjesën e mbetur të kampionatit. Verdhekuqtë janë rikthyer të interesohen për Michy Batshuayi, i cili aktualisht luan i huazuar te Valencia, por kartoni i tij zotërohet nga Chelsea. Ish-lojtari i Borussia Dortmundit nuk po bind me paraqitjet në Spanjë, ku ka realizuar vetëm tre gola dhe, sipas medieve angleze, lojtari mund të rikthehet në Londër për t'u huazuar sërish te ndonjë ekip tjetër. Po sipas asaj që raportojnë në Angli, në "Pole Position" për shërbimet e sulmuesit është Crystal Palace, por as italianët nuk mbeten pas, pasi kanë kohë në ndjekje të belgut.

Nesër më 24.12.2018 behën 14 vjet pa më të dashurin tonë



Liridon (Sejdi) Dërmaku

(17.07.1983 - 24.12.2004)

Bir, vëlla e axhë kaluan 14 vjet që kur të vrau armiku, i cili ishte dhe është kundër bashkimit kombëtar. Ti pusho i qet në dheun e Shqiptarisë, sepse Shqipëria po bëhet e do të bëhet ashtu siç ti dhe luftëtarët e lirisë e latë amanet. Në çdo përvjetor tëndin na pyesin, nëse po mërzitemi e po kemi mall për ty. Është e pamposhtur dhembja dhe i padurueshëm malli për ty, por krenaria që dhe jetën për jetët e shqiptarëve dhe Shqiptarisë na jep forcë që të vazhdojmë përpara. Ti je atje ku gjenden më të mirët e kombit, duke i bërë roje atdheut. Nderime Atdheut dhe lavdi ty dhe të gjithë dëshmorëve të rënë për lirinë dhe bashkimin e shqiptarëve. Gjithmonë krenarë me ty!

Të kujtojnë dhe kurrë s'të harrojnë: Nëna Feridja, babai Sejdiu dhe e tërë familja Dërmaku nga Shipashnica e Epërme e Dardanës dhe Prishtina.



TrafikuUrban

K O N K U R S

Pozita e punës: Depoist

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 1 vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheqë evidencën e pranimit dhe shpërndarjen e të gjitha materialit për nevojat e TU (materialin e zyrave, pjesë të ndryshme të autobusëve, vajrat, yndyrat karburante) etj sipas nevojës.
- Përgatit raport ditorë, javor dhe mujorë për çdo shpenzim dhe shpërndarje të materialit, shpenzimet e karburanteve dhe vajrave në autobus si dhe shpërndarjen e materialit për zyre dhe nevojave tjera, shpërndarjen e pjesëve rezervë të autobusëve.
- Furnizimin e depos me material, pjesë rezervë dhe pjesë tjera sipas nevojë e ndërmarrjes bëhet vetëm në bazë të urdhërësës së udhëheqësit të njësisë apo të menaxherit ose personit të autorizuar duke i respektuar procedurat.
- Regjistron harxhimin e materialit dhe pjesëve rezervë dhe është përgjegjës për to, bën arsyeshmërinë e shpërndarjes të çdo pjese, kujdeset për kursimin e materialit,
- Bën pranimin e çdo materiali që arrin në depo, evidentimin e saktë të hyrje daljeve nga depoja, sistemimin e tyre në vendet e caktuara si barkodimin e tyre na harmoni me procedurat e menaxhimit të depos.
- Bën regjistrimin e kërkesave për materialin e dhënë nga depoja, bën regjistrimin, evidentimin e çdo materiali që pranon nga furnitorët.
- Futja e shënimeve në kompjuter (në sistemin informativ), asiston në barazimin me kontabilitet gjatë regjistrimit vjetor, sistemon materialin e kthyer në depo nga Departamentet tjera .
- Për punën e vetë raporton te drejtori i administratës.
- Drejtori i administratës mund ta ngarkojë me detyra tjera sipas nevojës së TU.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Diplomë e Shkollës Mesme
- Përvojë punës (përparësi).
- Të ketë patentë shofer kategoria B.
- Shkathtësi në kompjuter.
- Të ketë aftësi të shkëlqyera të punës dhe komunikim motivues në grupe.
- Aftësi organizative dhe ndërpersonale.
- Të jetë i përgjegjshëm/me, integritet dhe vetëbesim personal.
- Njohja e gjuhës Angleze (përparësi).
- Njohja e gjuhës Serbo – Kroate (përparësi).

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacionin për punësim i TU (i nënshkruar nga aplikanti/ja)
- Kopja e diplomës së shkollimit sipas kriterëve të kërkuara.
- Dëshmi mbi përvojën e punës nëse posedon.
- Kopjen e Letërnjoftimit
- Letër Motivuese (e nënshkruar nga aplikanti/ja)
- Dëshmi të patentë shofer kategoria B

Informata të përgjithshme:

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Mënyra e Aplikimit:

1. Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes e-mailit : punesimi@trafikurban-pr.com
2. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>)

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga data **24.12.2018** dhe përfundon më datë **07.01.2019** në ora 16:00.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara dhe të pa nënshkruara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.



OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m², dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m².

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

Informata më të hollësishme mund të merren në numrin e telefonit 001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë në celularin 044-166-580.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Life Kaloshi shpall te pavlefshme dëftesat nga klasa e 1 deri ne klasën e 8, Shkolla Fillore "Veli Ballazhi" Hani Elezit / Goranc

► Ajria Kurta shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I,II shmm "Luciano Motroni" Prizren

► Ajria Kurta shpall te pavlefshme dëftesat e vitit III ,IV dhe diplomën shmgi "Gjon Buzuku " Prizren

► Nurten Avdosoj shpall te pavlefshme diplomën shmgi "Gjon Buzuku " Prizren.

► Ramije Ukaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shf "Dëshmorët e Kabashit" Korishë.

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m². Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo *Philippines*, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A *Paraguay*, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. *Guatemala*, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. *Kosovo*, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda *Brazil*, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. *Lebanon*, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. *Czech Republic*, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC *Tajikistan*, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. *Bangladesh*, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia *Georgia*, Sales



AUTOSHKOLLA “RITMO – L”

**Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333